



RAPORT STUDIMOR
PËR VENDIMET E PROKURORISË PËR MOSFILLIMIN
DHE PUSHIMIN E PROCEDIMEVE PENALE
& PROCEDURAT PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE

Tirane, 2014

Ky raport studimor është përgatitur në kuadër të projektit “Për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet fuqizimit të shtetit të së drejtës (Klinika ligjore 7”. zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) dhe mbështetur financiarisht nga organizata suedeze “Civil Rights Defenders” (ish Komiteti Suedez i Helsinkit)



Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Civil Rights Defenders

Përgatiti publikimin për shtypshkrim:

Ma.Av. Etilda Gjonaj (Saliu), *Drejtuese programi, KSHH*

ISBN:

Botoi : Shtëpia Botuese “Vllamasi”

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen e autorit

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Rr. Brigada e 8-te, Pallati “Tekno Projekt”
Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania
Kutia Postare nr.1752
Tel: 04 2233671
Cel: 0692075732
E-mail: office@ahc.org.al;
Web site: www.ahc.org.al

PËRMBAJTJA

1.Hyrje	5
KREU I	10
PARIMET KUSHTETUESE TË LIDHURA ME INSTITUTET	
PROCEDURALE TË MOSFILLIMIT TË ÇËSHTJEVE PENALE E TË PUSHIMIT TË TYRE DHE CAKTIMIN E MASAVE MJEKËSORE DHE EDUKUESE	
<i>Përgatiti: Petrit PLLOCI dhe Kujtim PUTO</i>	10
1.Parimet kushtetuese të lidhura me Institutet proceduriale të mosfillimit të çështjeve penale e të pushimit të tyre	10
1.1 Dallimi midis funksionit të Prokurorit e funksionit të Gjykatës	15
1.2 E drejta e ankimi (e drejta për t’ju drejtuar gjykatës)	17
2. Parimet kushtetuese në përcaktimin dhe marrjen e masave mjekësore dhe edukuese	20
2.1 Parimi i ligjshmërisë	21
2.2 Parimi i dinjitetit njerëzor (humaniteti)	22
2.3 Parimi i prezumimit të pafajësisë	23
KREU 2	24
Trajtimi i disa parimeve kryesore të nocioneve proceduriale – penale për institutet e mosfillimit dhe pushimit të procedimeve penale si dhe të ekzekutimit të vendimeve penale	
<i>Përgatiti: Niazi Jaho</i>	24
2.1 Mosfillimi i procedimit penal	24
2.2 Pushimi i çështjes penale	27
2.3 Ekzekutimi i vendimeve penale	28
KREU 3	32
DISA GJETJE TË STUDIMIT TE VENDIMEVE TE PROKURORISË DHE GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR PËR PUSHIMIN DHE MOSFILLIMIN E PROCEDIMEVE PENALE	
<i>Përgatiti: Etilda Saliu Gjonaj</i>	32
3.1Mbajtja e dokumentacionit përkatës lidhur me vendimet e prokurorisë në Prokuroritë e Tiranës dhe të Durrësit	33
3.1 Disa nga gjetjet kryesore nga studimi i vendimeve të prokurorisë	34
3.2.1 Të dhëna sasiore mbi vendimet e studiuara	34

3.2.2 Subjektet që kanë iniciuar procesin	35
3.2.3 Objekt i çështjeve për të cilat është vendosur pushim ose mosfillim i procedimit penal	38
3.2.1 Njoftimet e vendimeve të prokurorisë për personat e interesuar	40
3.2.6 Afatet e hetimit	41
3.3. Gjetjet kryesore nga studimi i vendimeve gjyqësore për kundërshtimin e vendimeve të prokurorisë	44
3.3.1 Disa të dhëna sasiore lidhur me studimin	44
3.3.2 Subjektet që kanë kundërshtuar vendimin në Gjykatën e rrethit gjyqësor	44
3.3.3 Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore për kundërshtimin e vendimeve të mosfillimit dhe pushimit të procedimit penal	47
3.3.4 Dispozitivi i vendimeve gjyqësore	50
3.3.5 Ankimimet e vendimeve gjyqësore	53
3.4 Legjitimitimi i palëve për kundërshtimin e vendimeve të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal – Rast litigimi strategjik	55
KREU 4	62
PROCEDURAT DHE AFATET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE ME BURGIM DHE MASAT MJEKËSORE DHE EDUKUESE	
<i>Përgatiti: Etilda Saliu Gjonaj</i>	62
4.1 Mbajtja e dokumentacionit në prokuroritë dhe gjykatat e monitoruara	62
4.2 Të dhënat sasiore nga Gjykata.	64
4.3 Afatet e respektuara për arsyetimin e vendimeve gjyqësore nga gjykatat	65
4.4 Afatet e respektuara për dërgimin e vendimeve nga sekretaria gjyqësore drejtuar prokurorisë	67
4.5 Urdhrat e ekzekutimit të organit të akuzës dhe afatet e ndjekura	68
4.6 Ekzekutim i masave mjekësore dhe edukuese	71
5. Konkluzione dhe Rekomandime	74

1. Hyrje

Sistemi gjyqësor është një shtyllë e rëndësishme që duhet të garantojë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve si dhe rivendosjen e tyre në rastet kur ato janë shkelur nga shteti apo subjekte të tjerë të së drejtës. Reforma në drejtësi gjithashtu ka qënë kryefjala e progres raporteve të Komisionit Europian dhe të gjithë aktorëve ndërkombëtare. Analiza e veprimtarisë së këtij sistemi është një mekanizëm substancial i veprimtarisë së Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH). Aksesit i shtetasve në organet e drejtësisë dhe respektimi i të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor janë dy nga prioritetet që KSHH ka patur në fokus të vazhdueshëm të aktivitetit të tij prej vitesh dhe që në mënyra të ndryshme monitorim se si respektohen këto dy të drejta kryesore.

Komiteti shqiptar i Helsinkit (KSHH), si një organizatë për të drejtat e njeriut, në fokusin e saj lidhur me sistemin e drejtësisë gjatë dy viteve të fundit, ka patur dy institutet procedurale të mosfillimit të procedimit penal dhe të pushimit të procedimit penal si dhe ekzekutimin e vendimeve penale me burgim dhe masat mjekësore dhe edukuese.

Për shkak të ankesave të herëpashershme adresuar pranë KSHH-së lidhur me vendimet e prokurorisë për mosfillimin e hetimeve ose pushimin e tyre, KSHH ka kryer një studim të vendimeve të organit të prokurorisë dhe gjykatës në Rrethet Gjyqësore Tiranë dhe Durrës¹. Nga studimi ka rezultuar se për një numër të konsiderueshëm të çështjeve që hetohen, prokuroria vendos mosfillim ose pushim. Rastet e mosfillimit janë të shumta, të cilat sipas vendimeve të prokurorisë bëhen për shkaqe se nuk ka elementë të veprës penale, nuk ka autor, janë vepra që duhet të ndiqen nga vetë të dëmtuarit në gjykatë, nuk ka prova të mjaftueshme për fillimin e një procedimi penal, etj. Ajo që vëmë

¹ Studimi është realizuar në kuadër të projektit “Për një respektim më të mirë të të drejtave të njeriut, Klinika Ligjore”, mbështetur financiarisht nga organizata Suedeze Civil Rights Defenders

re si një rezultat të përmbledhur është se në disa vendime vihet re se nuk janë kryer veprime hetimore ose ato nuk janë bërë të plota, neglizhencë nga ana e prokurorit për të hetuar në pista të ndryshme, etj.

Sipas ankesave të përcjella nga qytetarët ka rezultuar se ka një numër të konsiderueshëm çështjesh penale, dosjet e të cilave prej vitesh janë pa autor, për shkak se nuk është bërë i mundur identifikimi i tyre. Në bazë të nenit 58, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se *“I dëmtuari ka të drejtë të parashtojë kërkesa në organin procedues dhe të kërkojë marrjen e provave. Kur kërkesa e tij nuk pranohet nga prokurori, ai ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda ditëve nga marrja dijani.”*

Megjithatë, KShH vëren se personave të dëmtuar dhe trashëgimtarëve të tyre nuk i jepet një rol aktiv në procesin hetimor dhe më tej, kur çështja i kalon gjykatës. Në bazë të praktikës së gjykatave shqiptare pavarësisht interpretimit të zgjeruar që duhet t'i bëhet ligjit, kanë ngritur një praktikë të gabuar duke mos i dhënë mundësi trashëgimtarëve të kundërshtojnë vendimin e Prokurorisë për mosfillim hetimesh në Gjykatë, duke bërë kështu “varrosjen” njëherë e mirë të vendimeve të tilla.

Pavarësisht sa më sipër, KSHH vlerëson se ekziston nevoja e një rishikimi cilësor të Kodit të Procedurës Penale. Ministria e Drejtësisë dhe organet vendimmarrëse të cilat e kanë rishikuar Kodin duhet të zgjerojnë konsultimet me grupet e interesit, avokatë, gjyqtarë, prokurorë, organizata jofitimprurëse, studiues të së drejtës penale, etj.

Të gjitha këto aspekte janë përfshirë në këtë raport studimor, duke patur si qëllim jo vetëm evidentimin e problematikës për vendimet e prokurorisë dhe të gjykatës për mosfillimin dhe pushimin e procedimit penal dhe ekzekutimet e vendimeve penale, por edhe për të dhënë rekomandime për përmirësimin e situatës.

Objekt i këtij studimi janë evidentimi i problematikave të vendimeve të prokurorisë për mosfillimin dhe pushimin e procedimit penal, të vendimeve gjyqësore me objekt kundërshtimin e vendimeve të prokurorisë, monitorimin e procedurave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me burgim dhe masat mjekësore dhe edukuese.

Objekt i studimit ishin vendimet gjyqësore të periudhës 2009 – 2010 lidhur me kundërshtimin e vendimit të prokurorisë për Gjykatën e Rrethit gjyqësor Durrës dhe vendimet gjyqësore për vitin 2010 për Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë. Ndërsa lidhur me studimin e vendimit të mosfillimit dhe pushimit në Prokurorinë e Tiranës u studiuan vendimet vetëm për katër muaj për periudhën 2009 – 2010 (*u përzgjedhën në mënyrë random muajt nëntor - dhjetor 2009 dhe për vitin 2010*), ndërsa në Prokurorinë Durrës u studiuan vendimet që i përkisnin 6 mujorit të dytë të vitit 2009 dhe gjashtë mujorit të parë të vitit 2010.

Metodologjia e ndjekur ishte jo vetëm në aspektin teorik por dhe në atë të zbatimit në praktike. Në këtë raport studimor është paraqitur trajtimi i këtyre aspekteve në aspektin kushtetues, në aspektin e ligjit procedural penal, si dhe gjetjet kryesore nga monitorimi që është bërë i vendimeve dhe i dosjeve në Prokuroritë e rretheve dhe gjykatat e monitoruara.

Institucionet e monitoruara ishin Gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë dhe Durrës dhe Prokuroritë e këtyre rretheve gjyqësore.

Metodologjia e përdorur në Prokuroritë dhe në Gjykata e ndjekur u realizua nëpërmjet marrjes së takimeve me titullarët, prokurorë, gjyqtarë, administratën; u studiuan vendimet e prokurorive, rregjistrat përkatës për njoftimet, vendimet e gjykatave për kundërshtimin e vendimeve të prokurorisë, dosjet pëërkatëse në arshivë për secilin vendim dhe ndjekjen se deri në çfazë kanë shkuar; vendimet penale me dënim me burg dhe ato me masa mjekësorë dhe edukuese, rregjistrat me shënime për arsyetimin e vendimeve të gjyqtarëve; rregjistrat e dërgimit të vendimeve nga sekretari e gjykatës deri në prokurori, urdhërat e ekzekutimit në prokurori, rregjistri përkatës për ekzekutimet, etj.

Për shkak të shkallës së vështirësisë së këtij raporti studimor që nga metodologjia dhe deri te përgatitja e raportit përfundimtar, janë angazhuar një sërë ekspertësh me eksperience të gjatë në këtë fushë të gërshetuar me juristë të rinj të cilët kanë bërë studimin e vendimeve në praktikë.

Falë angazhimit të ekspertit z. Artan Hoxha, u përgatitën 4 lloje pyetësorësh sipas objektit dhe sipas institucionit të cilët shërbyen si guidë për përgatitjen e raportit për çështjet kryesore, objekt monitorimi. Gjithashtu njohuri të nivelit teorik dhe praktik së bashku me pyetësorët u trajtuan në një trajnim me ekspertët e përzgjedhur për të kryer monitorimin në terren. Monitorimi në gjykatat dhe prokuroritë u krye nga z. Gledian Llatja, znj. Eva Dyrmishi, z. Hipokrat Biba, z. Skerdian Kurti, znj. Enida Shameti dhe z. Engjell Likmeta . Të cilët nën udhëheqjen tepër profesionale të znj. Erida Skëndaj, Asistente programi pranë KSHH-së, arritën të kryejnë me profesionalizëm monitorimin e të gjitha çështjeve objekt studimi.

Në total u studiuuan 1100 vendimeve mosfillimi dhe pushimi të Prokurorive të rretheve gjyqësore Tiranë dhe Durrës² dhe studimi i 300 vendimeve gjyqësore të Gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë dhe Durrës³. Përmbledhja e raporteve të ekspertëve në aspektin statistikor për çështjet konkrete u bë nga z. Gledian Llatja.

Ish anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, z. Kujtim Puto dhe z. Petrit Plloçi bënë një studim të plotë të instituteve procedurale për mosfillimin dhe pushimin e procedimeve penale në aspektin kushtetues. Z. Niazi Jaho, këshilltar ligjor pranë KSHH-së trajtoi këto çështje në aspektin e ligjit procedural penal.

Të gjitha gjetjet kryesore dhe rekomandimet u bënë prezent në një tryezë të rrumbullakët në datën 30 janar 2014, ku nëpërmjet moderimit profesional të bërë nga znj. Vjollca Meçaj, Drejtore Ekzekutive e KSHH-së, u mbajtën një sërë diskutimesh nga pjesëmarrësit në këtë tryezë. Pjesëmarrës ishin përfaqësues të Prokurorisë së përgjithshme, të Institucioneve të monitoruara, Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të tjerë në fushën e drejtësisë.

² Vendime të prokurorisë së Durrësit I përkasin 6 mujorit të dytë të vitit 2009 dhe 6 mujorit të parë të vitit 2010, ndërsa për Prokurorinë e Tiranës për shkak të lartë të vendimeve I përkasin një periudhe 4 mujor të vitit 2009 dhe vitit 2010

³ Vendimet gjyqësore të Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë i përkasin vitit 2010 ndërsa për Gjykatën e Durrësit I përkasin vitit 2009 dhe 2010

Falë moderimit të bërë lidhur me diskutimet nga dy ekspertët e procedurës penale, z. Arben Rakipi dhe z. Artan Hoxha në këtë tryezë u arritën konkluzione dhe rekomandime tepër të rëndësishme që do të shërbejnë për përmirësimin e situatës.

Në fund të këtij prezantimi të shkurtër lidhur me qëllimin dhe se si është realizuar ky studim, gjëjmë rastin të falenderojmë të gjithë ekspertët që kanë kontribuar në realizimin e këtij studimi dhe shkrimin e këtij raporti studimor.

Falenderojmë në mënyrë të veçantë Kryetarët e Gjykatave të rretheve gjyqësore të Tiranës dhe Durrësit, z. Fatri Islamaj dhe z. Ervin Metalla dhe stafin e këtyre gjykatave për të gjithë gatishmërinë e treguar jo vetëm në aksesin e dhënë në dosjet dhe vendimet por dhe për informacionin dhe ndihmën e dhënë në evidentimin e dosjeve dhe vendimeve përkatëse, objekt studimi.

Një falenderim shkon dhe për Prokuroritë e rretheve gjyqësore të Tiranës dhe Durrësit, Drejtuesit dhe stafin e këtyre institucioneve të cilët gjithashtu na dhanë aksesin dhe informacionin e nevojshëm për të kryer monitorimin.

Gjëjmë rastin të falenderojmë dhe organizatën suedez Civil Rights Defenders për mbështetjen që na ka dhënë jo vetëm për këtë studim por për mbështetjen e veprimtarisë sonë në fushën e drejtësisë për një periudhë të gjatë me qëllimin përmirësimin e situatës të respektimit të të drejtave të njeriut, sidomos në fushën e gjyqësorit.

KREU I

PARIMET KUSHTETUESE TË LIDHURA ME INSTITUTET PROCEDURALE TË MOSFILLIMIT TË ÇËSHTJEVE PENALE E TË PUSHIMIT TË TYRE DHE CAKTIMIN E MASAVE MJEKËSORE DHE EDUKUESE

1. Parimet kushtetuese të lidhura me Institutet procedurale të mosfillimit të çështjeve penale e të pushimit të tyre

Veprat penale janë shkelje të ligjit, të cilat cënojnë rëndë të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe vlerat e tjera të mbrojtura nga Kushtetuta, dhe ndikojnë negativisht në kushtet e nivelit të jetesës së njerëzve dhe cënojnë bazat e shtetit dhe shoqërisë. Prandaj në ushtrimin e funksioneve të tij dhe duke vepruar në interes të të gjithë shoqërisë, qëllimi i shtetit si organizatë politike e shoqërisë në tërësi, është të sigurojë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të garantojë interesin publik.

Në këtë kuadër shteti ka jo vetëm të drejtën por edhe detyrimin të sigurojë një mbrojtje efektive të të drejtave dhe lirive të njeriut, të vlerave të tjera të mbrojtura nga Kushtetuta, të sigurojë një mbrojtje të çdo individi dhe të të gjithë shoqërisë nga përpjekjet kriminale duke përdorur masa ligjore me qëllim që të godasë fajtorët dhe të parandalojë krimet e shkeljet e tjera të ligjeve.

Në qoftë se shteti nuk ndërmerr veprime të përshtatshme për zbulimin, hetimin e dënimin e fajtorëve si dhe për parandalimin e krimeve, besimi në pushtetin e shtetit dhe ligjit do të rrënohet, mosrespektimi për rendin juridik dhe institucionet e ndryshme sociale do të rritet.

Masat e përcaktuara e të zbatuara nga shteti, për parandalimin e veprave penale dhe kufizimin e uljen e kriminalitetit duhet të jenë efektive. Në Kushtetutë është sanksionuar koncepti i një shteti demokratik, ku shtetit jo vetëm i kërkohet të mbrojë personin dhe

shoqërinë nga krimet e shkeljet e tjera të rrezikshme të ligjit, por duhet ta bëjë këtë duke mos lejuar që organet e tij të shpërdojnë kompetencat e tyre në dëm të qytetarëve të pafajshëm. Në këtë drejtim ka ndikim të madh sanksionimi i normave procedurale për pushimin e mosfillimin e çështjeve penale. Si dhe interpretimi e zbatimi i këtyre normave nga prokuroria e gjykatat.

Normat procedurale që kanë të bëjnë me mosfillimin dhe pushimin e çështjeve penale duhet të interpretohen në radhë të parë në kontekstin e parimit kushtetues të shtetit të së drejtës i cili është një parim universal nga udhëhiqet gjithë sistemi juridik i Republikës së Shqipërisë.

Thelbi i parimit kushtetues të shtetit të së drejtës është sundimi i të drejtës, ndërsa imperativi kushtetues i tij është që liria e pushtetit të kufizohet me ligj të cilit duhet t'i binden të gjitha entitetet e marrëdhënieve ligjore. Prandaj parimi kushtetues i shtetit të së drejtës duhet të respektohet si në ligjënie, ashtu dhe në ligjzbatim.

Duke u nisur nga kjo, rezulton se parimi i shtetit të së drejtës kërkon nga ligjvënësit, veç të tjerave, që aktet ligjore nuk duhet të përmbajnë dispozita që të rregullojnë një marrëdhënie në mënyrë të ndryshe, që aktet ligjore nuk lejohet të kërkojnë të pamundurën (*lex non agit ad impossibilia*) që fuqia e akteve ligjore të jetë për të ardhmen dhe të mos pranohet vlefshmëria prapavepruese e ligjeve e akteve të tjera normative (*lex retron non agit*), përveç kur akti ligjor lehtëson situatën e subjektit të marrëdhënieve ligjore dhe nuk dëmton subjekte të tjera të këtyre marrëdhënieve ligjore.

Kur rregullohen marrëdhëniet e procedurës penale, duhet të respektohet parimi kushtetues i barazisë së individit në të drejta. Në vendimet e saj Gjykata Kushtetuese, më tepër se një herë, ka vlerësuar se, në miratimin e ligjeve dhe në zbatimin e tyre, si dhe në administrimin e drejtësisë, duhet të respektohet parimi kushtetues i të drejtave të barabarta të personave, se ky parim kushtetues vendos detyrimin e vlerësimit në mënyrë ligjore të fakteve homogjene në të njëjtën mënyrë, dhe ndalon vlerësimin arbitrar të tyre, se ky parim konsolidon barazinë formale të gjithë personave, pra që njëra palë të mos diskriminohet apo t'i ofrohen privilegje në kurriz të tjetrës.

Parimi kushtetues i shtetit të së drejtës në procesin e zbatimit të

ligjit nënkupton të drejtën e personit për një proces të drejtë ligjor, që prokuroria e sidomos gjykata të respektojnë kërkesën e barazisë së personave në të drejta, të mos lejojnë hetimin e dënimit dy herë për të njëjtën vepër (*non bis in idem*) që sanksioni (*dënimi*) penal për shkeljet e ligjit të jetë i përcaktuar që më parë (*in advance*), (*nulla crimen sine lege*), etj.

Në këtë kontekst duhet të theksohet gjithashtu se parimi kushtetues i shtetit të së drejtës kërkon që institucionet juridiksionale dhe institucionet e tjera, kur aplikojnë ligjin të jenë të paanshme, të pavarura, të zbulojnë të vërtetën objektive dhe të marrin vendime të bazuara vetëm në ligj e në prova. Angazhimi për një shtet të së drejtëse për respektimin e dinjitetit e personalitetit njerëzor të sanksionuara në preambulën dhe nenin 4 të Kushtetutës presupozon që çdo individ dhe e gjithë shoqëria duhet të jetë, e mbrojtur nga përpjekjet e paligjshme kundër tyre.

Në këtë kuadër kur përcaktohet përgjegjësia për shkeljet e ligjit duhet të respektohet kërkesa e arsyeshmërisë dhe parimi i proporcionalitetit, sipas të cilit marrja e masave ligjore duhet të jetë e domosdoshme se këto masa ligjore duhet të jenë në përshtatje me qëllimet legjitime dhe përgjithësisht të rëndësishme, se gjatë zbatimit të ligjit ato nuk lejojnë të kufizohen të drejtat e personit më tepër se sa është e domosdoshme.

Në një shtet të së drejtës vetëm me ligj mund të përcaktohet se cilat vepra janë penale dhe cili është lloji i përgjegjësisë ligjore për vepra të tilla. Vetëm ato që janë vërtet të rrezikshme, mund të njihen, në mënyrë legjislative si vepra penale. Kur rregullon marrëdhëniet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale legjislatura gëzon një diskrecion të gjerë. Ajo (*legjislatura*) mund, mes të tjerash, duke marrë parasysh natyrën, shkallën e rrezikshmërisë dhe veçori të tjera të veprave penale, të përcaktojë rregullime të diferencuara ligjore e nje përgjegjësi penale të diferencuar për veprat penale koresponduese.

Megjithatë, ky diskrecion i legjislaturës nuk është absolut: legjislatura duhet të respektojë normal dhe parimet e Kushtetutes, mes të tjerash, edhe urdhërimet e rregullsisë dhe harmonisë së brendshme të sistemit juridik, që burojnë nga Kushtetuta.

Detyrimi i shtetit që buron nga Kushtetuta, për të garantuar sigurinë

e çdo personi dhe shoqërisë në tërësi nga përpjekjet kriminale, nënkupton jo vetëm të drejtën dhe detyrën e legjislaturës për të përcaktuar me ligj se cilat janë vepra penale e sanksionet për to, por nënkupton edhe të drejtën e detyrën e saj (legjislaturës) për të rregulluar marrdhëniet që lidhen me hetimin e veprave penale dhe gjykimin e tyre. Marrdhëniet e procedurës penale duhet të rregullohen me ligj, në mënyrë që të krijohen parakushtet ligjore për zbulimin dhe hetimin e shpejtë dhe të plotë të veprave penale, për të dënuar me drejtësi personat që i kane kryer ato, si dhe për të krijuar parakushtet ligjore që të pafajshmit të mos merren në përgjegjësi penale e të mos dënohen.

Siç ka vlerësuar Gjykata Kushtetuese e R.SH rregullimi me ligj, i procedurës penale duhet të bazohet në parimin kushtetues të ligshmërisë të barazisë para ligjit e para gjykatës, prezumimit të pafajësisë, të gjykimin të drejtë dhe publik, ndarjes së funksioneve të gjykatës dhe prokurorit, e të statusit të pavarur të ketij të fundit, etj. Jo vetëm kaq, por organet e ngarkuara me hetimin e gjykimin e veprave penale duhet të respektojnë të drejtat e personave nën hetim apo të pandehur, siç janë e drejta për t'ju drejtuar gjykatës (*e drejta e aksesit në gjykatë*), e drejta për një gjykatë të drejtë e të paanshme, pavarësia e gjyqtarit dhe e gjykatës në administrimin e drejtesisë, detyrimi i gjyqtarit për të pezulluar gjykimin e çështjes në rastin kur i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

Rregullimi me ligj i procedurës penale nuk mund të krijojë asnjë parakusht për vonesa në hetimin e gjykimin e çështjeve penale, e as të krijojë ndonjë parakusht që pjesëmarrësit e procesit penal të abuzojnë me të drejtën e tyre procedurale në dëm të të drejtave të individëve. Përndryshe, obligimet kushtetuese të shtetit për të siguruar me masa ligjore sigurinë e çdo personi dhe të shoqërisë në tërësi, si dhe zbatimin e rendit juridik të bazuar në vlerat kushtetuese, do të bëheshin më të vështira.

Kompetenca e prokurorit për mosfillimin apo pushimin e çështjeve penale e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale të R.Sh si aspekt i funksionit të tij kushtetues (*Neni 148 i Kodit*) është në pajtim me parimin e shtetit të së drejtës. Ky parim presupozon që shteti duhet të marrë të gjitha masat për të mbrojtur dinjitetin e njeriut të drejtat e liritë e tij,

rendin kushtetues, pronën etj, si edhe të sigurojë që asnjë person të mos ndiqet dhe dënohet penalisht në mënyrë të padrejtë.

Për të përmbushur detyrimet e mësipërme e sidomos atë që asnjë person të mos ndiqet penalisht padrejtësisht ligjvënësi ka përcaktuar me ligj rastet e mosfillimit apo pushimit të çështjeve penale. Ndjekja penale përfshin dy faza të lidhura me njëra tjetrën në mënyrë funksionale: fazën e hetimeve paraprake, që konsiston në kryerjen e veprimeve hetimore për të mbledhur prova, për të identifikuar autorin dhe për të ndërtuar akuzën në se gjenden elementë të veprës penale dhe fazën e gjyqimit që konsiston në ballafaqimin para gjykatës të akuzës me mbrojtjen dhe në dhënien e vendimit nga gjykata për fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit.

Lidhur me fazën e hetimeve paraprake në legjislacionet e shteteve te ndryshme konkurojnë dy parime: Parimi i ligjshmërisë dhe Parimi i oportunitetit.

Sipas parimit të oportunitetit i takon vetë prokurorit të vendosë se për cilat çështje duhet të filojë çështjen penale dhe sipas cilës rradhitje ose prioritet. Sipas Kodit të Procedurës Penale të R.Sh-së vendimarrja e prokurorit ashtu si edhe e gjykatës udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë. Kjo do të thotë se prokuroria zhvillon gjithë veprimtarinë brenda kompetencave të caktuara me ligj. Më konkretisht kjo do të thotë që përcaktimi i kushteve ligjore të mosfillimit apo pushimit të çështjes penale është bërë nga ana e ligjvënësit "*Prokurorit nuk i lejohet të vendosë të mosfillojë ose pushojë një çështje penale jashtë kriterëve ligjore. Diskrecioni i prokurorit qëndron vetëm në faktin se atij i është lënë kompetenca të vlerësojë nëse, në pretendimet konkrete që ka për trajtim, përmbushen ose jo këto kriterë*". (Vendimi i Gj.K Nr. 14, dt. 21.07.2008)

Kodi jonë i procedurës penale ndërsa i ka lënë prokurorit kompetencën të vlerësojë në procedimet konkrete nëse përmbushen apo jo kriteret ligjore, nuk ka pranuar gjithashtu modelin e ndjekjes penale të detyrueshme sipas të cilit prokuroria nuk mund ta pushojë vetë ndjekjen penale, por duhet t'ia kërkojë atë gjykatës. Prandaj, sipas nenit 328 të K.Pr. Penale prokuroria nuk fillon ndjekjen penale, ose nëse e ka filluar duhet ta pushojë atë ndër të tjera, kur nuk arrin të provojë se i pandehuri ka kryer veprën penale ose kur i rezulton se fakti nuk përcaktohet si vepër penale etj. Veprimi i kundërt do të binte

ndesh me parimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së prokurorit parashikuar nga neni 4ç1 e 148ç3 i Kushtetutës si dhe nga neni 24ç2 i K.Pr.Penale.

1.1 Dallimi midis funksionit të Prokurorit e funksionit të Gjykatës

Institetet e hetimit para gjyqësor (*nga prokuroria*) dhe mbrojtjes së akuzës në emër të shtetit të sanksionuara në Kushtetutë nënkuptojnë modelin e përgjithshëm kushtetues të procedurës penale sipas së cilës hetimi në prokurori dhe gjykimi i çështjes penale në gjykatë janë faza të ndryshme të procesit penal. Kodi i Procedurës Penale, i ka dhënë kompetencë si prokurorisë ashtu edhe gjykatës të vendosin mosfillimin e çështjeve penale ashtu edhe pushimin e tyre.

Por ndërsa shkaqet e mosfillimit e të pushimit të çështjeve përgjithësisht janë të njëjta (*fakti nuk ekziston, mungojnë elementet e veprës penale, vepra penale është shuar, personi është dënuar edhe më parë për të njëjtën veprë etj*), nuk do të thotë se janë të njëjta dhe funksionet e të dy organeve. Funksioni kushtetues i dhënies së drejtësisë nga gjykatat është i ndryshëm nga funksioni i ndjekjes penale që ushtron prokurori. Kjo ndarje është bërë e qartë që në Kushtetutë. Sipas nenit 148ç1 të saj, ndjekja penale ushtrohet nga prokuroria ndërsa sipas nenit 135, funksioni gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë. Dhënia e kompetencës për ndjekje penale prokurorisë nënkupton që është kjo që mbledh dhe vlerëson të dhënat e domosdoshme për të vendosur nëse hetimi duhet të fillojë, nëse pas hetimeve çështja penale duhet të pushohet apo dërgohet gjykatës dhe nëse është e mundur që me provat e mbledhura të zhvillohet gjykimi i çështjes me drejtësi nga gjykata.

Duke ushtruar ndjekje penale Prokuroria bën hetime dhe ngre akuzë publike në emër të shtetit. Ushtrimi i ndjekjes penale nënkupton gjithashtu që prokuroria të ketë kompetencën t'i propozojë gjykatës masën e sigurisë në varësi të rrezikshmërisë shoqërore të personit e nevojave të hetimit, të pyesë dëshmitarë e ekspertë, të kërkojë dokumenta, të bëjë kontroll personi, e banese, etj. Hetimi para gjyqësor duhet të kryhet në mënyrë objektive, të kualifikuar të paanshme, të plotë dhe të mblidhet informacion i mjaftueshëm për gjykatën, që të

marrë një vendim për çështjen penale. Parimi i procesit të rregullt ligjor kërkon që jo vetëm në gjykatë por edhe në prokurori veprimet e kryera dhe vendimet e marra duhet të jenë të qarta e të bazuara në argumenta ligjore.

Në ndryshim nga prokuroria gjykata është i vetmi organ i shtetit që administron drejtësi. Ajo shqyrton një çështje që është përgatitur nga prokuroria mbi bazën e provave të paraqitura nga akuza dhe mbrojtja. Ajo vendos për fajësinë e të pandehurit, e dënon ose e deklaron të pafajshëm. Dispozita e nenit 135 të Kushtetutës, sipas të cilit pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat, në aspektin procedural, do të thotë se një person nuk mund të deklarohet fajtor për kryerjen e një vepre penale, e as mund t'i jepet një dënim penal pa një vendim gjykate të marrë në bazë të ligjit.

Kodi i Procedurës Penale, në nenin 290 ka përcaktuar rastet kur nuk mund të fillojë procedimi penal dhe në nenin 328 të saj rastet e pushimit të akuzës ose të çështjes nga prokurori ndërsa në nenin 387 kushtet e pushimit të çështjes nga gjykata.

Lidhur me kushtetueshmërinë e institutit të pushimit të çështjeve penale nga prokurori si dhe të disa rasteve të ketij pushimi është shprehur në disa vendime edhe Gjykata Kushtetuese e R.Sh. Kjo gjykatë në vendimin nr. 14, dt. 21.07.2008 ka shqyrtuar pretendimin e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda se prokurori nuk mund të marrë vendim për pushimin e çështjes ose akuzës sepse kjo vjen në kundërshtim me funksionin kushtetues të tij që është ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i akuzës në gjyq, në emër të shtetit. Sipas asaj gjykate dhënia e një kompetence të tillë prokurorit shkel parimin e paanësisë në dhënien e drejtësisë, etj.

Lidhur me pretendimet e mësipërme Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se kompetenca e prokurorit për mosfillimin apo pushimin e çështjes penale (*në rastet e parashikuara nga ligji*) është në pajtim me parimin e shtetit të së drejtës sipas të cilit shteti duhet të marrë masa për të mbrojtur dinjitetin e njeriut, të drejtat e liritë e tij, etj., dhe të sigurojë që asnjë person të mos ndiqet penalisht në mënyrë të padrejtë.

Qëllimi i Kushtetutës nuk ka qenë të vendosë barrierë kushtetuese për ushtrimin në mënyrë të detyruar të ndjekjes penale dhe prokurori të mos ketë drejtë ta pushojë atë, për që ky i fundit të hetojë e të

vlerësojë me objektivitet nëse janë kushtet ligjore për të çuar çështjen në gjykatë. Prandaj, prokuroria është organizuar dhe funksionon e shkëputur nga pushtetet e tjera, larg ndikimeve politike të mundshme.

Gjykata Kushtetuese, nuk është pajtuar as me arsyetimin se pushimi i çështjeve penale nga prokuroria përbën dhënie të drejtësisë dhe si e tillë ajo duhet të jetë funksion vetëm i gjykatës. Sipas asaj gjykate “kur ushtron ndjekjen penale prokurori vetëm mbledh provat për të vërtetuar akuzën dhe verifikon nëse ndodhet në kushtet që e detyrojnë të pushojë akuzën ose çështjen penale apo ta dërgojë çështjen në gjykatë. Është kjo e fundit që vendos për deklarimin fajtor ose të pafajshëm të të pandehurit, që do të thotë, se në ushtrimin e funksionit të dhënies së drejtësisë në kontekstin penal, është gjykata që vendos për themelin e akuzës së ngritur nga prokurori”.

Në vendimin nr.5, dt.08.03.2005 Gjykata Kushtetuese e R.Sh, pasi ka shqyrtuar kushtetuetshmërinë e togfjalëshit “... më shumë se një here...” parashikuar në nenin 278ç4 të K.Penal të lidhur ngushtë me kuptimin e zbatimit ne bis in idem (jo dy herë për të njëjtën vepër) ka arsyetuar në vendimin se sipas këtij parimi “..... individi nuk mund të ndiqet e nuk mund të gjykohet nga juridiksionet e të njëjtit shtet për një vepër penale për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm apo është dënuar në bazë të një vendimi gjyqësor përfundimtar të ligjshëm”.

Sipas këtij vendimi, ky parim çënohet “jo vetëm kur personi dënohet përsëri për të njëjtën vepër, por edhe kur ai ndiqet penalisht në mënyrë të përsëritur për këtë vepër”. Prandaj ky parim gjen zbatim edhe për rastet e mbrojtjes nga masat shtrënguese e ndaluese të cilat janë të lidhura ngushtë me procedimin në prokurori. Ky është edhe shkaku që në nenin 328çë të K.Pr.Penale është parashikuar si një nga rastet e pushimit të akuzës ose çështjes nga prokurori edhe kur më parë “me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale”.

1.2 E drejta e ankimi (e drejta për t'ju drejtuar gjykatës)

Sipas standarteve të vendosura nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), dhe nga Gjykata Kushtetuese e R.Sh, secili i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës dhe të kundërshtojë veprimet e vendimet e prokurorit sidomos vendimet e mosfillimit apo pushimit të çështjeve penale. Dispozita e nenit 42ç2 të Kushtetutës

sipas të cilës kushdo ka të drejtën t'i drejtohet gjykatës (*e drejta e aksesit në gjykatë*) dhe të drejtën e një gjykimi të drejtë, nënkupton që secilit duhet t'i jepet mundësia të mbrojë të drejtat e tij në gjykatë kundër vendimeve të institucioneve të shtetit apo zyrtarëve të tyre.

Kontrolli mbi prokurorinë në disa shtete bëhet nëpërmjet gjyqtarit hetues i cili është organi kompetent për të kontrolluar të gjitha veprimet hetimore paraprake, para se çështja t'i kalojë për gjykim gjykatës. Por, legjislacioni shqiptar ka pranuar kontrollin nga prokurori më i lartë e nga gjykata në se personi i interesuar vlerëson të kundërshtojë veprimet e prokurorit duke përfshirë edhe ato të mosfillimit apo të pushimit të çështjeve.

E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një e drejtë themelore e individit që nënkupton jo vetëm të drejtën për të kundërshtuar gjyqësisht një akt, por edhe ekzistencën e një organi të caktuar me ligj, të pavarur e të paanshëm, për shqyrtimin e ankimit. Gjithashtu, e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, e parë nga këndvështrimi i nenit 42ç2 të Kushtetutës, (*procesi i rregullt ligjor*) ka për qëllim t'u garantojë palëve në proces të drejtën për t'u mbrojtur duke i vendosur ato në çdo rast në pozita ta barabarta para gjykatës.

Në kontekstin e çështjes në shqyrtim duhet të vihet në dukje se në bazë të Kushtetutës, rregullimi ligjor duhet të jetë i tillë, që pjesëmarrësit e procesit penal, të cilët gëzojnë një status të njëjtë procedural (*viktimat, personat e dyshuar për kryerjen e një vepre penale, i akuzuari, prokurori, avokati etj*) të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Kështu, pjesëmarrësit në procesin penal, të cilët gëzojnë të njëjtin status procedural duhet të kenë edhe të njëjtat të drejta dhe detyrime, me kusht që të mos ketë dallime të një karakteri dhe shkalle të tillë, që trajtimi i pabarabartë të justifikohet objektivisht. Për ndryshe, do të devijojë nga parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës dhe të barazisë së personave.

Jurisprudenca kushtetuese dhe ajo gjyqësore ka ecur në drejtim të zgjerimit të rasteve të së drejtës së ankimit të individëve ndaj veprimeve apo mosveprimeve të prokurorit si dhe për çdo vendim mosfillimi apo pushimit të prokurorit. Kështu, në vendimin nr.5 dt.06.03.2009, Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën e R.Sh pjesën e nenit 329 të Kodit Penal që nuk lejonte

ankimin ndaj vendimit të pushimit të prokurorit që deklaronte “se fakti nuk ekziston”. Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese ka pranuar se dhënia formë të prerë vendimit të prokurorit për këto raste i mohon individit të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, se duke ju drejtuar gjykatës i krijohet mundësia e kontrollit të prokurorisë për vendimet e dhëna prej tij dhe se e drejta për t’iu drejtuar gjykatës është garanci e domosdoshme për të respektuar të drejtat e liritë e tjera themelore të shtetasve.

Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese e ka analizuar këtë të drejtë edhe në raport me nenin 17 të Kushtetutës që parashikon kriteret e kufizimit të të drejtave themelore. Sipas saj “Mosnënshtrimi i vendimit të prokurorit kontrollit gjyqësor jo vetëm që prek të drejtën e individit për t’iu drejtuar gjykatës, por nuk mbron ndonjë interes publik, i cili në parim është i prirur të ketë tendencë rritja e kontrollit gjyqësor ndaj akteve të pushtetit publik sesa në të kundërtën. Një gjë e tillë do t’i shërbente rrjedhimisht dhe rritjes së besueshmërisë së publikut tek drejtësia duke shmangur çdo përpjekje për vendimarrje abuzive nga organet e pushtetit publik”.

Sanksionimi kushtetues i modelit të përgjithshëm të procedurës penale, pra që çështjet penale hetohen nga prokuroria, nuk eliminon mundësinë që në raste të caktuara hetimi të mos kryhet nga prokurori, dheçose akuzat në emër të shtetit të mos mbrohen prej tij në gjykatë. Kushtetuta nuk e pengon sanksionimin me ligj të një lloji të tillë të procedurës penale, e cila për disa çështje me rrezikshmëri më të vogël shoqërore është, pak a shumë, e ndryshme nga modeli i përgjithshëm kushtetues i Procedurës Penale.

Në zbatim të parimeve kushtetuese të mësipërme K.Pr.Penale i R.Sh ka përcaktuar norma proceduriale më të detajuara duke i krijuar mundësi individëve që t’i drejtohen gjykatës jo vetëm kundër vendimeve të prokurorit për mosfillimin apo pushimin e çështjeve penale, por edhe në rastet e veprave penale me rrezikshmëri të vogël shoqërore, për të cilat ligjvënësi, sipas vlerësimit subjektiv të secilit, i kanë ardhur pasoja negative.

Sipas nenit 59/1 të K.Pr.Penale ai që është dëmtuar nga veprat penale të rrahjes, plagosjes nga pakujdesia, dhunimit të banesës, fyerjes, shpifjes, ndërhyrjes në jetën private, botimit të veprës me emrin e tjetrit

etj, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë, dhe të marrë pjesë në gjykim si paslë për të vërtetuar akuzën. Ligjvënësi ka parashikuar një rregullim të tillë ligjor, me të cilin për çështje të caktuara, akuzat të mos mbrohen nga prokurorët por nga personat privatë (përfaqësuesit e tyre) në prani të prokurorit. Një rregullim i tillë nuk krijon parakushte për të shkelur të drejtën e personit për mbrojtje gjyqësore dhe as kufizon parakushte për të shkelur të drejtën e personit për mbrojtje gjyqësore dhe as kufizon të drejtën kushtetuese të tij për t'iu drejtuar gjykatës (*e drejta e aksesit në gjykatë*). Kjo nuk do të thotë gjithashtu se ka shmangie nga parimi kushtetues i barazisë së personave në të drejta përderisa gjykata bën vlerësimin paraprak të kërkesës, analizon provat e paraqitura nga palët dhe vendos pranimin ose jo të kërkesës, pushimin e saj ose deklarimin fajtor apo të pafajshëm mbi bazën e provave të paraqitura nga i dëmtuari dhe i pandehuri.

2. Parimet kushtetuese në përcaktimin dhe marrjen e masave mjekësore dhe edukuese

Sipas nenit 46 të Kodit Penal masat mjekësore janë:

- a) Mjekimi i detyruar ambulator dhe
- b) Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor.

Ndërsa masa edukuese është vendosja e të miturit në një institucion edukimi.

Masat mjekësore paraqesin një lloj të veçantë të sanksioneve penale që në radhë të parë kanë karakter parandalues në luftën kundër kriminalitetit dhe që zëvendësojnë shpesh dënimet e ashpra ndaj personave të papërgjegjshëm ose personave me çrregullime psikike të një shkalle të tillë që u kanë ulur aftësinë perceptuese apo vetkontrolluese të veprimeve të tyre.

Masa edukative e vendosjes së të miturit në një institucion, ashtu si masat mjekësore, është sanksion penal që ka karakter parandalues, por masat edukative kanë si qëllim themelor jo vetëm parandalimin e kryerjes prej fajtorit të veprave të tjera penale, por edhe riedukimin e përgatitjen e tyre për jetën. Të miturit që kanë kryer vepra penale

dallohen nga të rriturit që kanë manifestuar sjellje të tilla jo aq nga llojet e veprave dhe sjelljeve kriminale, se sa për nga vetitë e tyre psikike, psikofizike dhe sociobiologjike.

Si parime themelore kushtetuese në përcaktimin, dhënien dhe ekzekutimin e masave mjekësore dhe edukuese mund të përmendim:

2.1 Parimi i ligjshmërisë

Buron nga neni 4 i Kushtetutës sipas të cilit “*E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit*”. Parimi i ligjshmërisë është baza e veprimtarisë të të gjitha organeve dhe institucioneve si për sanksionimin e kriterëve e masave në legjislacion, ashtu edhe për dhënien e sanksioneve ndaj personave që kanë kryer vepra penale e në marrjen e masave për të bërë të mundur ekzekutimin e këtyre sanksioneve.

Sipas këtij parimi duhet të përcaktohen me ligj dhe jo me akte nënligjore dhe as të lihen në diskrecionin e gjykatësit kriteret për dhënien e masave të sigurisë ose masave edukuese. Legjislatori duhet të kanalizojë e emëtojë kriteret mjaftueshmërisht të sigurtë që do të përcaktonin shkallën e rrezikshmërisë shoqërore e për pasojë mbylljen në një institucion edukimi. I pandehuri mund të kryejë vepër penale i ndikuar nga rrethanat, e jo për shkak të sëmundjes prandaj është ligji ai që duhet të përcaktojë gjithashtu diagnozat të cilat bëjnë të domosdoshme mbylljen për mjekim të detyruar.

Kuvendi duhet të bëjë përmirësime e ndryshime në nenin 46 të Kodit Penal duke vendosur kriteret të përcaktuara për dhënien e masave edukonjëse, si dhe të parashikojë me ligj elementët efektivë simptomatikë (*shprehitë, sjelljet*) që përcaktojnë nëse i mituri mund të kryejë krime.

Në këndvështrimin e veprimtarisë ekzekutive, parimi i ligjshmërisë dhe i shtetit të së drejtës kërkon që:

- Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Drejtësisë të hartojnë aktin normative;
- Të hartojnë rregulloren për trajtimin dhe ruajtjen e personave të dënuar me masa mjekësore;

- Ministria e Shëndetësisë të krijojë mjediset e përshtatshme për vendosjen e personave të dënuar me masa mjekësore;
- Këshilli I Ministrave të krijojë institucion edukues të posaçshëm në varësinë e Ministrisë së Arsimit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për masat edukuese;
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të vendosë të dënuarit e mitur në një seksion të veçuar për të garantuar një trajtim të veçantë të tyre nga të rriturit dhe të marrë masat për transferimin në kohë të të dënuarve me masa mjekësore nga dhomat e paraburgimit në spitalin e burgut ose në institucionin e veçantë në Krujë.

Parimi i ligjshmërisë kërkon gjithashtu, që gjatë kohës së mjekimit të detyruar ose të qëndrimit në institucionin e edukimit të dënuarve të mos u kufizohen të drejtat tej kufizimeve që parashikon ligji e rregullorja dhe që masat për kufizimin e të drejtave të tyre të jenë të domosdoshme dhe në përpjestim me nevojën e marrjes së tyre. Masat e kufizimit mund të zbatohen vetëm në raste të jashtëzakonshme, por edhe atëherë ato duhet të jenë të parashikuara e të kufizuara me ligj.

Parimi i ligjshmërisë presupozon edhe ushtrimin e mbikqyrjes, kontrollit e inspektimit të organeve për veprimtarinë që ushtrojnë për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës për masat mjekësore dhe edukonjëse.

2.2 Parimi i dinjitetit njerëzor (humaniteti)

Parimi kushtetues (*preambula dhe neni 28/5 i Kushtetutës*) i mbrojtjes e respektimit të dinjitetit njerëzor kërkon që të dënuarit duke përfshirë edhe personat ndaj të cilëve janë dhënë masa mjekësore dhe edukonjëse, të trajtohen në mënyrë që të mos preket personaliteti e dinjiteti njerëzor e moral dhe të respektohen vettitë e cilësitë njerëzore të çdo personi të dënuar që gjendet në entet ndëshkimore-përmirësuese. Megjithëse, një individ mund të ketë kryer vepër penale dhe të jetë marrë ndaj tij masë mjekësore e edukonjëse, ai nuk është i zhveshur nga subjektiviteti i tij njerëzor e moral. Ai nuk mund të trajtohet gjithashtu sikur është i zhveshur nga disa veti e të mira

universale natyrore njerëzore, aq më tepër që në sistemet bashkëkohore modern është pranuar e shpallur që qëllimi i dënimit nuk është hakmarrja apo shpagimi, por riedukimi dhe rikthimi i të dënuarit në shoqëri si qytetar korrekt.

Në shtetet demokratike kujdesi e respektimi i vlerave njerëzore të individit gjatë qëndrimit në entet ndëshkimore përmirësuese është rregulluar me akte juridike të organeve më të larta. Në këto akte gjejmë formulime ku garantohet trajtimi human dhe respektimi i personalitetit dhe dinjitetit të njeriut.

2.3 Parimi i prezumimit të pafajësisë

Parimi i prezumimit të pafajësisë (*neni 30 i Kushtetutës*) mund të interpretohet në një masë të kufizuar edhe në rastin e personave ndaj të cilëve kërkohet të merret masa mjekësore e edukonjëse.

Gjykata Kushtetuese italiane me vendimin nr.364 dt.24.03.1988 ka pranuar se nuk mund të aplikohen masat kufizuese ndaj subjekteve që shprehin tendenca kriminale në se ata nuk kanë kryer vepra penale.

Dilema se a duhet këto masa të ndërmerren para se të kryhet vepra penale apo pas kryerjes së saj është zgjidhur nga legjislacioni ynë në mënyrë të tillë që këto masa mund të ndërmerren vetëm ndaj atyre që kanë kryer vepra penale dhe që vlerësohen njëkohësisht se do të përsërisin sjelljet kriminale e do të kryejnë vepra penale. Në këtë mënyrë, nëpërmjet këtij qëndrimi i është vënë barierë arbitraritetit të organeve shtetërore në favor të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut.

KREU 2

TRAJTIMI I DISA PARIMEVE KRYESORE TË NOCIONEVE PROCEDURIALE – PENALE PËR INSTITUTET E MOSFILLIMIT DHE PUSHIMIT TË PROCEDIMEVE PENALE SI DHE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Ky material trajton kryesisht probleme të natyrës juridike në përputhje me Kodit të Procedurës Penale, Kodit Penal dhe ligjin mbi ekzekutimin e vendimeve penale. Nëpërmjet këtij kreu, qëllimi është për një kuptim më të drejtë të nocioneve proceduralo-penale të mosfillimit dhe pushimit të çështjeve penale si dhe ekzekutimit të vendimeve penale me burg duke përfshirë edhe masat mjekësore dhe edukuese.

Siç dihet, bazuar dhe në nenin 148 të Kushtetutës, prokuroria ushtron ndjekjen penale. Ai ka të drejtë të hetojë vetë, madje kur e çmon të nevojshme, të fillojë çështjen me iniciativën e vet. Shumica e hetimeve kryhen nga policia gjyqësore, megjithëse vendimin për fillimin ose mosfillimin e ndjekjes penale e merr prokurori. Ai ushtron kontroll mbi ecurinë e hetimit, jep udhëzime dhe urdhëron zbatimin e tyre. Vlen të përmendet se procedimi penal mund të fillojë ose mosfillojë edhe me njoftimin (*kallëzimin*) që mund të bëhet nga të tjerët siç mund të jenë shtetasit (*midis tyre mund të jenë edhe të dëmtuar*), institucionet shëndetësore, si dhe institucionet e tjera. Të dhënat për kryerjen e një vepre penale duhet të verifikohen me kujdes për të konkluduar nëse ka elemente të veprës penale dhe nëse autori i saj është ose jo i përgjegjshëm.

2.1 Mosfillimi i procedimit penal

Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e ndjekjes penale dhe që prokurori mund të vendosë mosfillimin e saj janë:

- a) Kur fakti i denoncuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;
- b) Kur vepra penale është shuar me parashkrim;
- c) Kur vepra penale është amnistuar;
- d) Kur del qartë që fakti nuk ekziston.

Tre rastet e para nuk është e vështirë të verifikohen. Mjafton të shihet Kodi Penal dhe ligjet e tjera për të konkluduar nëse rasti i denoncuar parashikohet ose jo si vepër penale. Veprat penale sipas Kodit Penal ndahen në krime dhe kundërvajtje penale. Duhet ti referohemi gjithashtu nenve 66 dhe 71 të Kodit Penal ku bëhet fjalë për parashkrimin e ndjekjeve penale dhe për amnistinë.

Ka patur raste kur prokurori e ka lidhur mosfillimin e ndjekjes penale me mosekzistencën e veprës penale. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në një rast të tillë ka shfuqizuar vendimin e prokurorit me arsyetimin se për të arritur në këtë përfundim, prokurori duhet të fillonte çështjen (*vendim nr.65 datë 30.01.2002*). Në vendimin e mësipërm të Gjykatës së Lartë thuhet gjithashtu se nëse fakti ekziston ose jo dhe nëse vepra është kryer nga personat e kallëzuar, ky përfundim mund të nxirret vetëm pasi të jenë kryer hetimet lidhur me rrethanat e çështjes.

Duhet bërë dallimi midis rastit kur fakti nuk parashikohet si vepër penale dhe rastit kur fakti nuk ekziston. Në rastin e parë çështja mund të mosfillojë, ndërsa në të dytin duhen zhvilluar hetimet.

Sipas nenit 12 të Kodit Penal, nuk ka përgjegjësi penale nëse personi e ka kryer veprën penale në kohën kur nuk ka mbushur moshën 14 vjeç, ndërsa për kundërvajtjet penale nuk ka përgjegjësi penale nëse nuk ka mbushur moshën 16 vjeç. Në të dy këto raste, nëse ka kallzime, prokurori nuk duhet të fillojë ndjekjen penale. Për këtë del nevoja që paraprakisht të verifikohet moshja e personit. Nëse papërgjegjshmëria është e lidhur me gjendjen mendore dhe kjo konstatohet para fillimit të procedimit penal, gjithashtu ai nuk duhet ta fillojë atë.

Nuk lejohet fillimi i çështjes penale, nëse nga kallzimi rezulton se bëhet fjalë për ndonjë vepër që ndiqet vetëm me ankimin e të dëmtuarit dhe për këtë nuk është paraqitur ndonjë ankim. Se cilat janë veprat që ndiqen me ankimin e të dëmtuarit duhet t'i referohemi nenit 284 të Kodit Procedurës Penale. Procedimi penal nuk mund të fillojë

gjithashtu edhe në rastet e parashikuar nga neni 290 i K.Pr.P, si të tilla mund të përmendim: personi ka vdekur, është i papërgjegjshëm, nuk ka mbushur moshën etj., si dhe në të gjitha rastet e tjera të parashikuar në ligje (*neni 290, pika 1, shkronja "e"*).

Në këtë grup përfshiheshin edhe personat që gëzonin imunitet, mirëpo me ligjin nr.88/2012 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8417 dt. 21.10.1998, Kushtetuta e R.Sh-së", neni 73 ku flitet për imunitetin, ka pësuar disa ndryshime. Janë ndryshuar gjithashtu nenet 126 dhe 137 të Kushtetutës. Sipas nenit 291 të Kodit të Proçedurës Penale, kur ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e proçedimit, prokurori me vendim të arsyetuar vendos mosfillimin e proçedimit.

Vlen të theksohet se ky vendim duhet të jetë i arsyetuar, sepse kjo i jep mundësinë atij që ka bërë kallzimin ose ankim, që brenda 5 ditësh të bëjë ankim në gjykatë. Prokurori është i detyruar që këtë vendim t'ua njoftojë atyre menjëherë, duke iu referuar pikërisht përmbajtjen e këtij arsyetimi. Vlen të përmendet se sipas ndryshimit të nenit 73 të Kushtetutës, deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria me çfarëdo lloj forme, apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit. Kjo do të thotë se nuk kërkohet autorizim në rastet kur vendoset fillimi i çështjes penale.

Sipas neneve 126 dhe 137 të Kushtetutës (*ndryshuar në vitin 2012*), në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë.

Gjatë monitorimit kemi konstatuar edhe raste kur jo vetëm vendimet për mosfillimin e çështjes penale nuk janë arsyetuar në mënyrë bindëse, por edhe në ndonjë rast kur janë kryer disa veprime hetimore (*edhe pse të pamjaftueshme*) në vend që të vendosej pushimi i çështjes, është marrë vendim për mosfillim çështjeje penale. Mund të përmendim këtu rastin e vdekjes në spitale të të dënuarit Sh.K në të cilën pavarësisht se ishin kryer veprime hetimore, Prokuroria e Rrethit gjyqësor Tiranë vendosi mosfillimin e procedimit penal. Ndërsa, kur të afërmit të të ndjerit e kundërshtuan vendimin e prokurorisë në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë, kjo e fundit vendosi të mos e legjitimojë bazuar në nenin 291/2.

2.2 Pushimi i çështjes penale

Jo çdo çështje që fillohet shkon në gjykatë. Ka raste kur çështja mund të pushohet ose të pezullohet (*kur nuk gjendet autori ose kur autori vuan nga një sëmundje e rëndë*). Megjithëkëtë, pushimi i çështjes mund të bëhet kur hetimi ka qenë i gjithanshëm, kur janë mbledhur dhe fiksuar të gjitha provat e mundshme. Pushimi i çështjes vendoset në bazë të nenit 328 të Kodit të Proçedurës Penale.

Rastet kur prokurori ka të drejtë të vendos pushimin e çështjes.

Nëse gjatë hetimeve rezulton se fakti nuk ekziston (*për këtë mund të konkludohet vetëm pasi të jenë bërë hetimet përkatëse*) duhet të vendoset pushimi i çështjes dhe si rrjedhojë edhe pushimi i akuzës që mund të jetë bërë ndaj të pandehurit. Praktika ka vërtetuar se këto janë raste të rralla. Kjo ndodh vetëm në ato raste kur çështja penale ka filluar në bazë të një denoncimi të rremë që mund të jetë bërë për motive nga më të ndryshme. Për mungesë të faktit, çështja mund të pushojë edhe në rastet kur në Kodin Penal, vepra penale e pretenduar ose vepra që rezulton gjatë hetimeve nuk parashikohet në Kodin Penal.

Çështja duhet pushuar edhe nëse ka filluar kur i dëmtuari nuk ka bërë ankim ose kur heq dorë nga ankimi. Por në këtë drejtim duhen patur parasysh rastet kur hetimet fillojnë vetëm me kërkesën e të dëmtuarit. Prandaj duhet t'i referohemi nenit 284 dhe 285 të KPrP-së-së ku parashikohen veprat penale që ndiqen vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili ka të drejtë të heqë dorë në çdo fazë të proçedimit. Në raste të tilla prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore mban proces-verbalin përkatës që nënshkruhet nga deklaruesi (dmth nga kallzuesi ose përfaqësuesi i tij).

Hetimi pushon gjithashtu kur rezulton se personi i marrë si i pandehur nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale ose veprën e ka kryer për shkak të gjendjes mendore. Si me rastin e parë edhe në të dytin, duhet të ketë prova që e vërtetojnë këtë siç janë: certifikata të gjendjes civile, raporte të komisioneve mjekësore të specializuara, etj. Prokurori duhet të vendosë pushimin e çështjes kur rezulton se vepra penale është kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme të parashikuar nga neni 19 i K.P. Në praktikë ndeshemi më shumë me raste kur del se

i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale, ose kur gjatë hetimeve nuk vërtetohet që t'a ketë kryer ai. Në të dy këto raste çështja duhet të pushohet, sepse në rastin e parë është vërtetuar pafajësia e tij, ndërsa në rastin e dytë çdo dyshim duhet të interpretohet në favorin e të pandehurit. Kemi mendimin se pushimi i çështjeve në disa raste ndikohet nga zvarritja e çështjeve, mosmarrja në kohë të provave, zbehja ose zhdukja e tyre.

Pushimin e çështjes, siç u përmend më lart, prokurori duhet t'a mbështesi në përcaktimet e bëra në nenin 328 të KPrP. Vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe duhet t'i komunikohet të dëmtuarit dhe të pandehurit. Ankimi bëhet në gjykatën e rrethit gjyqësor.

Në nenin 329 të KPrP thuhet se njoftimi nuk bëhet kur fakti nuk ekzistonte. Mirëpo Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr.5 dt.6.03.2009 ka shfuqizuar këtë përjashtim të parashikuar nga neni 329 i KPrP-së. Gjykata Kushtetuese është shprehur se shtetasi duhet të ketë akses në gjykatë, se vendimi i pushimit të çështjes nga prokurori nuk përbën dhënie drejtësie, se kjo është kompetencë vetëm e gjykatës. Si rrjedhim i dëmtuari dhe i pandehuri duhet të kenë të drejtë të ankohen në gjykatë edhe në rastet kur pushimi i çështjes bëhet me motivimin për mosekzistencë të faktit, ose kur ai është i dyshimtë.

Megjithëse në nenin 329 të KPrP-së bëhet fjalë vetëm për të dëmtuarin dhe të pandehurin, të drejtën e ankimit duhet ta ketë edhe çdo person ose institucion që bën ankim (*kallzim, denoncim*), kështu psh, Kontrolli i Lartë i Shtetit, etj. Është në kompetencën e gjykatës që shqyrton ankimin të vendosë bazueshmërinë ose jo të vendimit të pushimit të marrë nga prokurori.

2.3 Ekzekutimi i vendimeve penale.

Ky është një moment mjaft i rëndësishëm. Ekzekutimi i vendimeve penale jo në përputhje me ligjin mund të shoqërohet me pasoja të dëmshme. Do të përqëndrohemi kryesisht për dënimet me burg që parashikon neni 33 i KP. Si dënimi me burg edhe dënimi me burgim të përjetshëm ekzekutohen në institucionet e caktuara posaçërisht për këtë qëllim, ndërsa rregullat për mënyrën e vuajtjes së dënimit, të drejtat dhe detyrat e të dënuarve caktohen me ligj.

Legislacioni në mënyrë të veçantë ka specifikuar se dënimin me burg, i të miturve duhet të kryhet në vende të veçanta, kjo do të thotë jo bashkë me të rriturit, ndërsa gratë duhet të kryejnë dënimin me burgim në institucione të veçantë, d.m.th. jo në institucionet ku janë burrat.

Vlen të përmendet se ekzekutimi i vendimeve penale rregullohet me ligj të veçantë. Praktika ka vërtetuar se prokurorët pranë gjykatës së shkallës së parë ka raste që nuk zbatojnë me rigorozitet kërkesat e nenit 463 të K.Pr.P. ku ata ngarkohen të marrin masa për ekzekutimin e vendimit dhe kur është rasti të kërkojnë kryerjen e veprimeve të veçanta nga prokurori i një rrethi tjetër. Në të gjitha rastet zbatohet gjithashtu kërkesa e pikës 4 të nenit 463 të K.Pr.P që detyron prokurorin për të njoftuar me shkrim gjykatën që ka dhënë vendimin menjëherë sa të ketë filluar ekzekutimi i vendimit.

• **Veprimet e prokurorit për ekzekutimin e një vendimi me burgim.**

Prokurori duhet të nxjerrë urdhërin e ekzekutimit, i cili duhet të përmbajë gjeneralitetet e të dënuarit, dispozitivin e vendimit si dhe disponimet e nevojshme për ekzekutimin. Nëse i dënuari ndodhet në gjendje paraburgimi, urdhëri i dërgohet organit shtetëror që administron burgjet dhe i njoftohet të interesuarit, ndërsa kur i dënuari nuk është i paraburgosur urdhërohet burgimi i tij. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për rastet e ekzekutimit të vendimeve për mbylljen e detyrueshme në institucione mjekësore dhe edukimi. Prokurori në zbatim të nenit 465 të KPrP duhet të ketë parasysh llogaritjen e paraburgimit. Në nenin 465 thuhet se në caktimin e kohës së dënimit me burgim, prokurori llogarit periudhën e paraburgimit të vuajtur për të njëjtën vepër penale ose për një vepër penale tjetër, periudhën e dënimit me burgim të shlyer për një vepër penale tjetër, kur dënimi përkatës është revokuar, ose kur për veprën penale është dhënë amnisti apo falje. Mbas bërjes së llogaritjeve të mësipërme, prokurori nxjerr urdhërin që i komunikohet të dënuarit dhe mbrojtësit të tij.

Ka pasur raste që për shkak të moszbatimit të drejtë të nenit të mësipërm (ose për shkak të llogaritjeve të gabuara) i dënuari i është drejtuar gjykatës me ankim. Nëse lidhur me ekzekutimin e vendimit

lindin konflikte (cënim të ligjit, paqartësi, etj.) kompetente për shqyrtimin e këtyre ankesave është gjykata që ka dhënë vendimin. Ndërsa kur vendimet janë dhënë nga gjykata të ndryshme, kompetente është gjykata që ka dhënë vendimin, i cili ka marrë formë të prerë, i fundit. Në mbështetje të ligjit: "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim" gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesave të të dënuarve me burgim është gjykata në territorin e së cilës ndodhet institucioni. Në këtë drejtim është shprehur vendimi nr. 320, dt.09.05.2002 i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë.

Në KP janë parashikuar si masat mjekësore dhe edukuese. Masat mjekësore janë: a) Mjekimi i detyruar ambulator dhe b) mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor, ndërsa masë edukuese është vendosja e të miturit në një institucion edukimi. Këto masa, sipas rastit, jepen nga gjykata dhe revokohen po nga gjykata kur zhduken rrethanat në bazë të të cilave ato janë dhënë. Prokurori, sipas ligjit, për ekzekutimin e vendimeve penale është i detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit sipas urdhërimeve të gjykatës. Madje jo vetëm kaq, por edhe të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit, të ndërhyjë në organet kompetente, dhe po të jetë nevoja edhe në gjykimin për rivendosjen e ligjit. Vendimet me burgim, menjëherë sa marrin formë të prerë; gjykata ia dërgon prokurorit i cili kryen veprimet që përmendëm më lart.

Nëse gjykata nuk ka konstatuar se i dënuari duhet të vendoset në një institucion të veçantë, sipas njoftimit të prokurorit që i paraqet gjykatës të dhënat përkatëse, ajo urdhëron kontroll mjekësor dhe vendosjen në institucion të veçantë. Prokurorit i dërgohet gjithashtu, për ekzekutim, edhe vendimin me gjysmë-liri si edhe ekzekutim të vendimit me qëndrim në shtëpi.

• Përsa i përket ekzekutimit për masa mjekësore

Masat mjekësore me mjekim të detyruar, ekzekutohen në institucionet mjekësore të specializuara sipas përcaktimeve që bën Ministria e Shëndetësisë mbi kërkesën e prokurorit, ndërsa masat mjekësore me mjekim të detyruar ambulator ekzekutohen në institucionet mjekësore të vendbanimit të personit. Nëse ka pengesa

nga personi, prokurori urdhëron ekzekutimin të detyruar nga policia e shtetit.

- **Ekzekutim i masave edukuese**

Kjo masë ekzekutohet në institucionet e posaçme të edukimit të të miturve, dërguar në mënyrë vullnetare nga prindi ose kujdestari, mbi urdhërin e ekzekutimit të prokurorit. Por që ashtu siç dihet në Shqipëri, sot për sot nuk ekziston një institucion i tillë duke e bërë kështu të vështirë ekzekutimin.

KREU 3

DISA GJETJE TË STUDIMIT TE VENDIMEVE TE PROKURORISË DHE GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR PËR PUSHIMIN DHE MOSFILLIMIN E PROCEDIMEVE PENALE

Komiteti Shqiptar i Helsinkit si një organizatë që ka në fokusin e saj, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ka ndërmarrë këtë studim për të parë se si janë zbatuar parimet kryesore të procedurës penale dhe dispozitat përkatëse në praktikë.

Monitorimi i punës së prokurorisë lidhur me ndjekjen e procedurave dhe afateve ka qënë një ndër qëllimet kryesore të punës, gjithmonë në respektim të të drejtave të personave në kontakt me organet e drejtësisë.

Dy institutet që ne jemi përpjekur për ti ndjekur, mosfillimi dhe pushimi i procedimit penal paraqesin një rëndësi të madhe,

Nisur dhe nga numri i madh i vendimeve në një vit të Prokurorisë, për mosfillimin dhe pushim të procedimeve penale, rrit interesin për të parë se për cilat çështje më së shumti Prokuroria vendos mosfillim ose pushim dhe për cilat raste aktet dërgohen në gjykatë.

Nisur dhe nga ankesat e shumta adresuar pranë KSHH-së ose çështjet e litigimit strategjik që kemi dërguar në gjykatë, objekti i tyre lidhet me pretendime për vendime arbitrare të prokurorisë për mosfillim ose pushim të çështjeve.

çështje shqetësuese është dhe procedura që ndiqet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale me dënim me burg si dhe për masat mjekësore dhe edukuese.

Për këtë arsye, KSHH ndërmori një studim në Prokuroritë e rrethit gjyqësor Tiranë dhe Durrës dhe gjykatat e rretheve gjyqësore respektive. çështjet të cilat u bënë objekt studimi në Prokuroritë monitoruara ishin: mosfillimi i procedimit penal, pushimi i procedimit

penal, procedurat për ekzekutimin e vendimeve penale me burg. Në Gjykatat e monitoruara u bënë objekt studimi çështjet për kundërshtimin e vendimeve të prokurorisë për mosfillimin dhe pushimin e procedimeve penale, si dhe afatet dhe procedurat e ndjekura për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me burg dhe me masa mjekësore dhe edukuese. Për studimin e kryer u ndoq një metodologji e paracaktuar e shoqëruar me pyetësorët përkatës të përshkruara më në detaj dhe në hyrjen e këtij studimi.

3.1 Mbajtja e dokumentacionit përkatës lidhur me vendimet e prokurorisë në Prokuroritë e Tiranës dhe të Durrësit

Nga monitorimi rezultoi se lidhur me arshivën dhe sekretarinë, dosjet ishin sipas viteve të vendimeve dhëme rend kronologjik për Prokuroritë. Ambjentet fizike lënë për të dëshiruar në Prokurorinë e Durrësit dhe atë të Tiranës për shkak të hapësirës së kufizuar dhe lagështisë.

Nga verifikimi na rezultoi se vendimet e pushimit dhe mosfillimit nuk ishin të listuara në përmbledhje të veçanta sipas viteve por ndodheshin në dosje të veçanta, kjo në Prokurorinë e Durrësit. Në asnjë nga prokuroritë si ajo e rrethit gjyqësor Tiranë dhe ajo e Durrësit, gjatë periudhës së monitorimit nuk kishte një database të dhënash dhe gjithçka punohej manualisht, gjë që bën shpeshherë dhe në përfundimin e statistikave jo të sakta.

Në Gjykatën e rretheve gjyqësore të Tiranës dhe të Durrësit arshiva ishte me hapësira të kufizuara gjë që vështirësonte studimin fizik të dosjeve në ambjentet përkatëse. Nga monitorimi rezultoi se dosjet dhe regjistrat ishin të ruajtura në rend kronologjik por mungonte një database elektronike e mbajtjes së tyre. Por ashtu si në Institucionet e Prokurorisë, nxjerrja e informacionit objekt studimi nga dosjet dhe regjistrat u bë në mënyrë manuale, pasi nuk disponohej një database i të dhënave dhe nuk ishin të ruajtura në rrugë elektronike.

Zyrat nuk kishin sistem ajrimi. Sipërfaqja e vogël e ambienteve të arshivës në të dyja Gjykatat krahasuar më vëllimin e dosjeve bënte që dosjet ruheshin të pasistemuara dhe pa një rend kronologjik. Shumë dosje ishin të lëna në tokë për shkak të mungesës së ambienteve, por

edhe të bazës material (rafte, dollapë) dhe kjo mund të passjellë dëmtimin e tyre. Në arshivë nuk kishte të dhëna për mungesën e dosjeve të caktuara, të cilët nuk rezultonin në shkallën e parë, për shkak të ankimit të tyre në shkallët më të larta të gjyqësorit.

Por në dallim nga Prokuroritë e rretheve gjyqësore, duke qenë se gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë ka faqen e saj në internet, shumë të dhëna gjendeshin lehtësisht, duke lehtësuar dhe punën e administratës.

Nga të katër Institucionet e monitoruara, disponibiliteti i titullarëve dhe i administratës ishte i lartë duke na vënë në dispozicion dosjet gjyqësore, regjistrat dhe të dhënat e kërkuara.

3.1 Disa nga gjetjet kryesore nga studimi i vendimeve të prokurorisë


3.2.1 Të dhëna sasiore mbi vendimet e studiuara

Pavarësisht se si në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë dhe në atë Durrës, numri i vendimeve të mosfillimit dhe pushimit është i lartë, fokusi i punës sonë studimore ka qënë për një periudhë të shkurtër. Kjo me qëllim për të konstatuar problematika të ndryshme të cilat mund të burojnë si nga ligji ashtu dhe nga procedurat e brendshme si dhe nga zbatimi I tyre në praktikë.


Në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë, u monitoruan për një periudhë dy mujore të vitit 2009 dhe 2010 gjithsej 557 dosje me vendime mosfillimi dhe 117 dosje me vendime pushimi. Ndërsa në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës u monitoruan dosjet që I përkisnin periudhës Korrik 2009 – qershor 2010, gjithsej 331 dosje me vendime mosfillimi dhe 172 dosje me vendime pushimi.

Nr vendimesh te studiuara	Prokuroria Tirane	Prokuroria Durres
Vendime mosfillimi	557	331
Vendime pushimi	117	172
Total	674	503

Tabela 1. Të dhëna sasiore për vendimet e studiuara



Grafiku1. Të dhëna sasiore për vendimet e studiuara në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë




Grafiku2. Të dhëna sasiore për vendimet e studiuara në Prokurorinë e Rrethit gjyqësor Durës

3.2.2 Subjektet që kanë iniciuar procesin

Nga monitorimi ka rezultuar se disa nga çështjet të cilat janë pushuar ose është vendosur mosfillim janë iniciuar nëpërmjet referimit të çështjeve nga policia, kallzimeve të individëve, Institucioneve shtetërore dhe inicimit vetë nga organi i prokurorisë. Ajo për të cilën për ne ka patur interes është që të dihet se sa këto kallzime bëhen nga

Institucionet shtetërore kur për shkak të funksionit dhe kompetencave që ju njeh ligji, bien ndesh me vepra penale të ndryshme.



Grafiku 3. Subjektet që kanë inicuar, referuar ose bërë kallzime për vepra penale


Nga studimi që i është bërë vendimeve të mosfillimit dhe pushimit në Prokuroritë përkatëse, rezulton se në Prokurorinë e Durrësit, në rastet e çështjeve me vendim pushimi nga prokuroria, 75 çështje janë me kallzim. Ndër këto 38 kallzime janë bërë nga individët dhe pjesa tjetër nga institucionet shtetërore. Ndërsa 97 çështje janë me referim nga komisaritet.

Për mosfillimet e çështjeve penale po në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës, ka rezultuar se 62 çështje janë me kallzim, ku 43 prej tyre janë nga individët ndërsa 19 nga institucionet shtetërore. Ndërkohë 269 çështje janë me referim nga komisaritet.


Në Prokurorinë Tiranë, në rastet e çështjeve me vendim pushimi, ka rezultuar se 16 çështje janë me kallëzim nga individët, 10 çështje për kallëzimet e ardhura nga institucionet shtetërore, 2 çështje të filluara kryesisht dhe 89 vendime për procedimet penale me referim të komisariteve. Për çështje që është vendosur mosfillimi, ka rezultuar se janë iniciuar në 27 çështje nga kallëzimet e institucioneve shtetërore, 60 vendime mosfillimi nga qytetarët dhe 470 vendime mosfillimi për rastet e referuara nga policia.

Rastet e referuara nga Komisaritet në Prokuroritë përkatëse janë shpesh në numër të lartë, pasi në disa raste ka rezultuar se kur i

kallëzuar ishte nën 14 vjeç, individët tërhiqnin kallëzimin ose rezultonte të ishin çështje civile.



Grafiku 5. Të dhëna për subjektet që kanë inicuar rastin që ka përfunduar me vendimmosfillimi



Grafiku 6. Të dhëna mbi subjektet që kanë inicuar rastin që ka përfunduar me vendim pushimi

3.2.3 Objekt i çështjeve për të cilat është vendosur pushim ose mosfillim i procedimit penal

Nga monitorimi i kryer dhe studimi i vendimeve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës, rezultoi se objekti i çështjeve për mosfillimet më së shumti kanë qënë për këto vepra penale: Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor (34 vendime); Krimet kundër jetës si Kanosja parashikuar nga neni 84 i KP (30 vendime); Dëmtime të tjera me dashje parashikuar nga neni 90i KP (21 vendime); vrasja me dashje (10 vendime); Shkaktimi i vetvrasjes parashikuar nga neni 99 i KP (26 vendime); Plagosja e lehtë me dashje parashikuar nga neni 89 KP (20 vendime).

Më të pakta por që nuk kanë munguar kanë qënë dhe këto vepra penale, dhunimi i banesës parashikuar nga neni 112 I KP; Heqja e paligjshme e lirisë; Mashtrimi parashikuar nga neni 143 i KP; Shkatërrimi i pronës sipas nenit 150 të KP; Falsifikimi i dokumentave sipas nenit 186 të KP; Pengimi për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës parashikuar nga neni 320 i KP-së; Vjedhja sipas nenit 134 të KP; Kalimi i paligjshëm i kufirit sipas nenit 297 të Kodit Penal, etj.

Përsa i përket vendimet e pushimeve, më së shumti kanë qënë çështjet me këto vepra penale: si shkatërrim i pronës sipas nenit 150 të Kodit Penal (10 vendime); Fallsifikim i dokumentave sipas nenit 186; Shpërdorimi i detyrës sipas nenit 248 të KP; Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor (neni 290 KP); Mashtrime në sigurime sipas nenit 145 të KP-së; plagosje e lehtë me dashje, etj.

Ajo që rezulton në të dy Prokuroritë e rretheve, por më së shumti në atë të Tiranës, objekti i kallzimeve nga qytetarët, duke futur këtu dhe kallzimet e individëve, që janë referuar nga komisariati janë kryesisht për veprat penale të vjedhjes, mashtrimit, falsifikimit.

Ndërsa, veprat penale të kallëzuara nga institucionet shtetërore kanë qënë më së shumti vjedhja e energjisë elektrike (*veprat penale të kallëzuara nga OSSH*), kontrabanda (*veprat penale të kallëzuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve*), shpërdorimi i detyrës (*vepra penale të kallëzuara nga KLSH*), vepra penale në fushën e taksave dhe tatimeve të kallëzuara nga Drejtoritë e Tatimeve, mashtrim në fushën e

sigurimeve shoqërore (*vepra penale të kallzuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, etj*).

3.2.4 Rastet e ankimit në shkallë hierarkike në organin e Prokurorisë

Nga ajo që kemi monitoruar na rezulton se Drejtuesi i Prokurorisë së rrethit gjyqësor ushtron kontroll mbi vendimet e mosfillimit dhe pushimit të Prokurorit të çështjes. Por në dokumentat që kemi studiuar në kuadër të këtij monitorimi, nuk na ka rezultuar se në cilat raste Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur të kthejë çështjen për rihetim ose ndryshimin e kualifikimit ligjor të çështjes ose në rastet e rihetura vetë.

Pavarësisht se Prokuroritë janë institucione të cilat përveç ndjekjes penale që i bëjnë çështjes, duhet të ndjekin se si çështja vazhdon, nëse kundërshtohet në gjykatë dhe çfarë vendos gjykata si dhe ankimin administrativ. Për shkak të mungesës të një database elektronike, kjo bën që Prokuroritë të mos kishin informacionin e saktë lidhur me ankimet, kthimet, etj.

Për periudhën e studiuar nuk u konstatua ndonjë rast ku palët të ishin ankuar në Prokurorinë e Përgjithshme (*me aq sa mund të evidentoheshin në dosje e monitoruara për secilin rast*) lidhur me vendimet e prokurorisë për pushimin e çështjes penale ose mosfillimin e kallëzimit penal. Nuk është identifikuar asnjë rast kur çështjet janë rikthyer për rihetim nga Prokuroria e Përgjithshme, që të jenë identifikuar nga inspektimet apo nga ankimet.

Palët nuk e kanë shfrytëzuar mundësinë për ankimim tek prokurori më i lartë. Mundësi procedurale kjo që nuk mund të evidentohet nëse lidhet me mungesën e besimit apo të njohjes së ligjit.

Dy arsye që ja vlejné për tu përmëndur dhe që ne i kemi evidentuar si shkaktare të numri të pakët ose zero gjatë periudhës së monitorimit për tju drejtuar PP janë:

- a) Vlen për tu theksuar që në vendimet e pushimit të çështjes ose mosfillimit të procedimit penal pasqyrohet vetëm e drejta e ankimit të vendimit në gjykata (*dhe këtu nuk specifikohet gjithmonë afati*) dhe jo ankimi administrativ në Prokurorinë e Përgjithshme.

- b) Gjithashtu mungesa e një afati të caktuar procedural për të kthyer përgjigje në rast ankimi nga qytetarët tek Prokuroria e Përgjithshme, si dhe mungesa e një afati në të cilën mund të rihetohet krijon vonesa dhe mungesë të drejtë të hetimit për shkak të kohës së pakufizuar që kalon. Dhe kështu mundet që mjet ankimi tepër efikas në përmbajtje të kthehet në një mjet joefektiv ankimi. Kjo do të kërkonte përcaktimin më të qartë të afateve të ankimit administrativ në Kodin e Procedurës Penale (neni 24ç5 i KPRP-së).

3.2.1 Njoftimet e vendimeve të prokurorisë për personat e interesuar

Ashtu siç parashikohet në Kodin e Procedurës Penale, si për vendimet e mosfillimit dhe pushimit të procedimit penal, organi i akuzës duhet të njoftoj subjektet e parashikuar në ligj. Sipas paragrafit të dytë të nenit 291 të KPRP-së parashikohet se “...Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë ankim ose kallzim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në Gjykatë brenda 5 ditëve nga data e njoftimit...”. E njëjta situatë është dhe në rastet e vendimit për pushim të procedimit penal të parashikuar nga neni 327 e vijues të Kodit të Procedurës penale.

Në Prokurorinë e Durrësit, ishte e vështirë të evidentohej nëse subjektet përkatëse ishin njoftuar dhe kur kishin marrë njoftim nëpërmjet konfirmimit. Ndërsa në Prokurorinë e rrethit Gjyqësor Tiranë rezultoi se njoftimet janë bërë përgjithësisht për të gjitha vendimet e mosfillimit dhe pushimit të procedimit penal. Në raste sporadike në aktet që i përkasin kallëzimit, nuk ka dokumentacion provues apo gjurmë që të vërtetojë njoftimin. Janë evidentuar 150 raste kur për shkak të adresave të pasakta apo ndryshimit të vendqëndrimit të palëve vendimi i mosfillimit ose ai i pushimit nuk u është dorëzuar palëve (kallëzuesit ose të dëmtuarve). çështja në këto raste ka filluar me referim të komisariatit drejtuar organit të akuzës.

Gjithashtu gjatë monitorimit ka rezultuar se vendimi i mosfillimit i është komunikuar jo vetëm kallëzuesve por edhe subjekteve të tjerë, të përfshirë në kallëzim, në cilësitë e të akuzuarit apo të dëmtuarit nga vepra penale objekt kallëzimi.

Në bazë të nenit 291, të Kodit të Procedurës Penale, ashtu siç është përmendur dhe sa më sipër thuhet se për çështjet për të cilat prokuroria ka vendosur mosfillimin, njoftimi i kallëzuesve ose ankuesve duhet bërë menjëherë me marrjen e vendimit. Në asnjë rast, nga rastet e monitoruara, në Prokurorinë e Tiranës për vendimet e mosfillimit nuk rezulton të jetë respektuar kjo kërkesë e ligjit procedural, pra njoftimi në mënyrë të menjëhershme.

Dhe në rastet kur Prokuroria e Tiranës, ka vendosur pushimin e gjykimit haset e njëjta problematikë. Vetëm se në këto raste ligji procedural nuk përcakton një afat për njoftimin e palëve të interesuara dhe është e vështirë për të dhënë një informacion se kur është bërë njoftimi. Por pavarësisht nga kjo, ky fakt nuk çënon të drejtën e palëve për të reaguar ndaj vendimit të pushimit, për shkak se kundërshtimi i vendimit të pushimit të procedimit apo mosfillimit mund të bëhet në çdo kohë, pas komunikimit të vendimit, por brenda afateve të parashkrimit.

3.2.6 Afatet e hetimit

Afatet e hetimit janë tepër të rëndësishme pasi çdo veprim hetimor i kryer jashtë afatit të përcaktuar, nuk mund të përdoret në gjykim, kjo referuar dhe në vendimin Nr. 67 të 4.02.2004 të Kolegjit Penal.

Sipas nenit 323 KPRP, parashikohet afatet për pushimin e çështjes, ku thuhet shprehimisht: se “... Brenda 3 muajve nga data në të cilën shënohet emri i personit qëi atribuohet vepra penale është shënuar në rregjistrin e njoftimit të veprave penale, prokurori vendos dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin ose pezullimin e saj...”

Sipas nenit 323 lidhur me afatin e hetimeve, afati i hetimeve paprarake nuk fillon nga data e rregjistrimit të veprës penale por nga data e rregjistrimit të emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale. Emri i të cilit rregjistrohet në rregjistrin përkatës, kjo e parashikuar dhe në urdhërin Nr. 1527 të Prokurorisë së Përgjithshme, dt 24.10.2000.

Lidhur me vendimet e mosfillimit nuk ka afate specifike dhe përgjithësisht janë respektuar afatet e procedimit të çështjes sipas nenit 323 të KPRP-së, për rastet e mosfillimit dhe pushimit të procedimit penal. Pavarësisht se gjatë studimit të vendimeve dhe monitorimit të

kryer në Prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga kontaktet me prokurorë, jemi vënë në dijenise për çështjet e mosfilluara ka një udhëzim të brendshëm, i cili cakton si afat të përfundimit të tyre 10 ditë.

Ajo që kemi evidentuar është se përgjithësisht janë respektuar afatet e procedimit të çështjes, për rastet e mosfillimit dhe pushimit të procedimit penal. Por në mënyrë specifike po e trajtojmë si më poshtë.

Lidhur me vendimet e mosfillimit brenda afatit 3 mujor, në Prokurorinë e Rrethit gjyqësor Durrës na rezultoi se 325 vendime mosfillimi janë proceduar brenda afatit ligjor (brenda afatit 3 mujor), 6 prej tyre jashtë këtij afati.


Ndërsa në Prokurorinë e Tiranës na rezultoi se 26 çështje për të cilat është vendosur mosfillim është shkelur afati ligjor dhe kanë vazhduar tej afatit 3 mujor pavarësisht se nuk na rezultoi të ishte kërkuar zgjatje e afateve të hetimit.

Përsa i përket vendimeve të pushimit rezultoi se në prokurorinë e Tiranës në 47 çështje të pushuara nuk janë respektuar afatet e përcaktuara 3 mujore, për të cilat në aktet e depozituara rezultoi se nuk është kërkuar zgjatje të hetimit. Në prokurorinë e Durrësit rezultoi se për 40 çështje nuk janë respektuar afatet përkatëse dhe për një numër tjetër vendimesh është e vështirë llogaritja e afateve.


Nga studimi i vendimeve të pushimit na ka rezultuar se më së shumti, se hetimi si kohëzgjatje totale kanë zgjatur për një periudhë 6 – 12 muaj. Dhe jo në të gjitha rastet kjo është shoqëruar në aktet e depozituara me zgjatje të hetimit.

Pavarësisht nga numri i vogël i këtyre çështjeve idhur me shkejen e afateve dhe procedurave për zgjatjen e tyre, mendojmë se duhet treguar vëmendje e veçantë dhe kontrole të herpashershme, pasi është shkelje procedurale që jo vetëm cënon procesin e rregullt ligjor, por edhe ndikon në realizimin e të drejtës.

Ajo që kemi evidentuar si problematike është se në shumë raste pasqyrimi i ecurisë së afateve është në diskrecionin e prokurorit, se kur konsiderohet data e fillimit të procedimit, datë nga e cila llogaritet ecja e afatit në rastet e pushimit të procedimit penal.



Grafiku7. Afatet e ndjekura nga prokuroria e Tiranës dhe e Durrësit për vendimet e mosfillimit



Grafiku 8. Afatet e ndjekura nga Prokuroritë e Tiranës dhe Durrësit lidhur me vendimet e pushimit

3.3. Gjetjet kryesore nga studimi i vendimeve gjyqësore për kundërshtimin e vendimeve të prokurorisë

3.3.1 Disa të dhëna sasiore lidhur me studimin

Objekt i studimit në Gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë dhe Durrës ishin çështjet për kërkesat për kundërshtimin e vendimeve të prokurorisë si për mosfillimin dhe për pushimin e procedimit penal.

Në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë u studiuan 218 vendime gjyqësore për kundërshtimin e vendimeve të mosfillimit dhe pushimit të procedimit penal, ndërsa në Gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës u studiuan 89 vendime për të dyja objektet.

Gjithsej janë studiuar në të dyja gjykatat 136 vendime për kundërshtimin e vendimeve të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal, ku 88 vendime i përkasin Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë dhe 48 asaj të Durrësit. U studiuan 71 vendime për kundërshtimin e vendimeve të pushimit të procedimit penal, ndër të cilat 130 i përkasin gjykatës së Tiranës dhe 41 Gjykatës së rrethit gjyqësor Durrës.

Në Gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës ka rezultuar se vetëm 2 kërkesa kanë qënë për kundërshtim të vendimeve për zgjatjen e afateve të hetimit. Problematikë e rezultuar gjatë monitorimit ishte se në rastet e zgjatjeve të afateve të hetimit të parashikuar në nenin 323ç2 të KPRP-së në të shumtën e rasteve të interesuar sipas nenit 58 të KPRP-së nuk njoftoheshin.


Ajo që vumë re nga studimi i të gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion është se në analizën vjetore që gjykata e rrethit gjyqësor këto tregues nuk diskutohen.

3.3.2 Subjektet që kanë kundërshtuar vendimin në Gjykatën e rrethit gjyqësor


Nga studimi rezulton se në Gjykatën e Rrethit Durrës janë kundërshtuar nga individët gjithsej 38 vendime dhe në 10 raste nga Institucionet shtetërore. Ndërsa në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë rezulton se 172 kërkesa janë bërë nga individët ndërsa 46 nga

Institucionet shtetërore.

Në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë vëmë re se në të shumtën e rasteve kërkesat janë bërë për pushimet më së shumti sesa për mosfillimet. Kjo vjen dhe për shkak të kufizimit që i jepet nga praktika e zbatimit të nenit 291ç2 të KPRP-së.




Grafiku 9. Të dhëna mbi subjektet që kanë kundërshtuar vendimet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë




Grafiku 10. Të dhëna mbi subjektet që kanë kundërshtuar vendimet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës

Nga studim i vendimeve në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, u vu re se 69 kërkesa janë bërë nga individët për mosfillimet, 103 kërkesa nga individët për pushimet, ndërsa nga institucionet shtetërore numri është i pakët, konkretisht 19 për mosfillimet dhe 27 për pushimet.

Ndërsa në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, 23 kërkesa për kundërshtim vendimi për mosfillimin e procedimit penal janë bërë nga individët, 15 kërkesa janë bërë nga individët për pushimin. Ajo që vihet re dhe në këtë gjykatë, është se numri i kërkesave për kundërshtim vendimi të bërë nga institucionet shtetërore është i vogël në krahasim me totalin e kërkesave, 4 kërkesa për vendimet e mosfillimin, dhe 4 për pushimin. Sa më poshtë paraqitja grafike për të patur një pasqyrë më të qartë të subjekteve dhe të kërkesave përkatëse.



Grafiku 11. Të dhëna për numrin e subjekteve në gjykatë për kërkesat e mosfillimit dhe pushimit



Grafiku 12 – Të dhëna për numrin e subjekteve në gjykatë për kërkesat e mosfillimit dhe pushimit

3.3.3 Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore për kundërshtimin e vendimeve të mosfillimit dhe pushimit të procedimit penal


Nga monitorim i kryer i çështjeve që kishte si objekt kundërshtimin e vendimeve të prokurorisë për mosfillimin ose pushimin e procedimit penal, u evidentua se kohëzgjatja e proceseve gjyqësore ishte tepër e lartë. Në një kohë që çështje të tilla duhet të jenë brenda një afati të shkurtër dhe të arsyeshëm me qëllim që dhe në rast se dosja kthehet për rihetime, periudha e kaluar mos të krijojë probleme në marrjen e provave apo kryerjen e ekspertizave të ndryshme.

Në të shumtën e rasteve, çështjet gjyqësore në Gjykatën e Tiranës kanë zgjatur mesatarisht 3 – 9 muaj. Më së shumti vëmë re se çështje të tilla janë gjykuar për një afat 6 muajor.

Konkretisht, me një afat tre mujor janë gjykuar 34 çështje mosfillimi dhe 39 çështje pushimi, për një afat 6 mujor janë trajtuar 24 çështje mosfillimi dhe 45 çështje pushimi, me afat 9 mujor – 4 çështje mosfillimi dhe 11 çështje pushimi, me afat 1 vjeçar janë gjykuar 3 çështje

mosfillimi dhe 5 çështje pushimi. Në një kohë që nuk kanë munguar dhe rastet kur çështje të tilla kanë zgjatur për rreth 2 vjet.

Në Gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës në krahasim me gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë ka një përshpejtim të afateve në gjykimin e çështjeve të tilla. Më së shumti çështjet janë gjykuar për një afat 3 muaj ndërsa mesatarisht kohëzgjatja e tyre është 3 – 6 muaj. Koncretisht brenda afatit 3 muaj janë gjykuar 51 çështje mosfillimi dhe 43 çështje pushimi, brenda afatit 6 muaj janë gjykuar 21 çështje mosfillimi dhe 6 çështje pushimi, në një afat 9 muaj janë gjykuar 5 çështje mosfillimi dhe 5 pushimi. Nuk janë evidentuar çështje të gjykuara në afat 1 vjeçar dhe vetëm në dy çështje pushimi, kohëzgjatja ka qënë dy vjeçare.



Grafiku 12. Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore për kundërshtimin e vendimeve të mosfillimit dhe pushimit në Gjykatat e Tiranës dhe Durrësit

Ashtu siç e kemi përmendur sa më sipër, duke pasur parasysh faktin që çështjet me objekt kundërshtimin e vendimit të prokurorisë janë kërkesa penale dhe gjatë tyre nuk paraqitet ndonjë provë e re, nuk thërriten dëshmitarë etj, veprime procedurale të cilat ndikojnë në zgjatjen e një procesi penale, konstatojmë se kohëzgjatja e tyre është e madhe.

Arsyet kryesore të evidentuara janë shtyrja e procesit gjyqësor dhe koha e gjatë nga një seancë tjetër. Janë palët ato që shtyjnë procesin, kryesisht kërkuesit, me kërkesa për shtyrjen e gjykimit. Gjithashtu problematike mbetet dhe mungesa e prokurorëve në seancë gjyqësore dhe në këto raste nuk i paraqet gjykatës as një kërkesë justifikuese. Duke shkaktuar në këtë mënyrë kohëzgjatjen e seancave tej afatit ligjor dhe tej një afati të arsyeshëm kohor.

Nga ajo çfarë na ka rezultuar është se nuk ka një procedurë të përsheptuar për këto kërkesa në asnjë nga shkallët e gjyqësorit. Madje dhe në Gjykatën e Lartë këto kërkesa qëndrojnë në listë pritje si të gjitha çështjet e tjera. Ajo që është vënë re gjithashtu është se kohëzgjatja e proceseve gjyqësore i tejkalon afatet mesatare. Nga 95 çështje me objekt kundërshtimin e vendimit të prokurorisë, të cilat janë për gjykim në Gjykatën e Lartë, mbi bazën e rekursit të bërë nga palët, deri në mesin e vitit 2013, vetëm 25% prej tyre janë gjykuar, ndërsa 75% e tyre presin ende në listë pritje duke rezultuar në proces studimi.

Problematikë është se në rast se do llogarisnim dhe kohën e hetimeve atëherë afatet e çështjeve penale, me objekt do të ishin akoma më të zgjatura. Po përmendim vetëm tre çështje, të cilat kanë rezultuar me njëkohëzgjatje më të lartë.


1. *Çështja që i përket vendimit gjyqësor Nr.49, datë 16.04.2010. Në këtë çështje kundërshtohet vendimi i prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal të vitit 2008. Çështja ishte pushuar një herë nga gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë dhe është rikthyer nga gjykata e apelit për rigjykim, e cila vazhdonte të ishte në proces gjyqësor gjatë periudhës së monitorimit.*
2. *Çështja që i përket vendimit gjyqësor nr.753, datë 27.04.2010. Në këtë çështje kundërshtohet vendimi i prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal të vitit 2007. Çështja ishte kthyer për rihetim dy herë nga Prokuroria e Përgjithshme.*
3. *Çështja që i përket vendimit gjyqësor nr.913, datë 21.05.2010. Në këtë çështje kundërshtohet vendimi i prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal të vitit 2006, kallëzimi i kryer në 2005, si dhe, e kthyer për rigjykim një herë nga gjykata e apelit.*

3.3.4 Dispozitivi i vendimeve gjyqësore

Nga studimi i vendimeve të gjykatës për kundërshtimin e vendimeve është vënë re se Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë ka vendosur:

- Pushimin e çështjes në 32% të vendimeve, konkretisht në 70 vendime, ku 36 vendime janë për pushimin dhe 34 për mosfillimin. Nga studimi që ju është bërë vendimeve të pushimeve është se në 90% të këtyre vendimeve janë për shkak të mosparaqitjes së kërkuarit dhe pse ka patur dijeni. Ndërsa 10% e tyre janë për shkak se kërkuari ka hequr dorë. Nga këto vendime pushimi vetëm 17 prej tyre kanë ushtruar të drejtën e ankimit.
- 23% të vendimeve ose 49 prej tyre, kanë qënë me pranim të kërkesës së bërë për kundërshtimin e vendimit, dhe kanë vendosur rikthimin për hetim në organin e akuzës.

Sa më poshtë paraqitja grafike:




Grafiku 13 – Paraqitja grafike për vendimet e gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë

Nga vendimet gjyqësore në Gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës kemi konstatuar se janë pushuar 10 çështje për mosparaqitje të kërkuarit, dhe 4 për heqje dorë nga kërkuari në seancë gjyqësore. Ndërkohë 6 vendime të gjykatës për pushim janë për kërkesat për kundërshtim të bëra nga Institucionet shtetërore, kur rezulton se për shkak të mosparaqitjes së tyre kjo kërkesë është pushuar pavarësisht marrjes së saj.

Gjykata në këto raste ka vendosur pushimin e çështjes, bazuar nën 387 të Kodit të Procedurës Penale kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhonte ose kur është shuar.

Sa më poshtë paraqitja grafike:




Grafiku 14 – Paraqitja grafike për vendimet gjyqësore të Gjykatës së rrethit gjyqësor Durrës

Një rëndësi në këtë studim i kemi kushtuar dhe kërkesave të bëra nga institucionet shtetërore për kundërshtimin e vendimit të prokurorisë për mosfillim ose pushim të procedimit penal. Kjo në ato raste të atyre institucioneve që në zbatim të kompetencave të tyre kanë bërë kallzim në prokurori dhe më pas është vendosur nga kjo e fundit mosfillimi ose pushimi i procedimit penal.


Konkretisht në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, nga 19 kërkesa për kundërshtim vendimi të ngritura nga Institucionet shtetërore në gjykatë, kjo e fundit ka vendosur pushim në 16 raste (pra rreth 84% të kërkesave të tyre). Kjo të lë të kuptosh që pavarësisht institucionet kanë

evidnetuar shkeljet përkatëse të krijon bindjen se ndoshta ato duhet të jenë më mirë të evidentuara dhe më mirë të provuara para organit të akuzës dhe gjykatës.



Grafiku 15 – Vendimi gjyqësor për kërkesat e ngritura nga Institucionet shtetërore

Lidhur me rastet kur gjykatat kanë vendosur me vendimin e tyre pranimin e kërkesës dhe kthimin për vazhdimin e hetimeve në prokurori, është konstatuar nga vendimet e studiuara se Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë ka vendosur kthimin për vazhdimin e hetimeve për 18 vendime për mosfillimin e procedimit penal dhe 31 vendime për pushimin e hetimeve.



Grafiku 16 – Vendimet gjyqësore që vendosin kthim të vendimeve të mosfillimit dhe të pushimit

Ndërsa nga ndjekja e ecurisë që i është bërë vendimeve gjyqësore të shkallës së parë për mospranim kërkesë në Gjykatat e Apelit, ka rezultuar se Gjykata e Apelit Tiranëka vendosur prishjen e vendimit të shkallës së parë dhe kthimin e akteve prokurorisë për vazhdimin e hetimeve për 5 vendime për mosfillimin e procedimit penal dhe 3 vendime për pushimin e hetimeve.

Vendimet e gjykatës së shkallës së parë, për kthimin e akteve prokurorisë për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme, pothuajse janë lënë në fuqi nga gjykata e apelit në tërësinë e tyre.

Ndërsa nga Gjykata e rrethit gjyqësor Durrës janë rikthyer për hetim gjithsej 6 çështje.

Gjatë studimit është vënë re se, në disa raste vendimet e gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë janë të paarsyetuara. Gjykata mjaftohet vetëm me pasqyrimin e rrethanave të faktit, si ka vepruar prokuroria, cili është objekti i kërkesës së palës dhe pa bërëarsyetimin e saj ka dhënë vendimin, i cili nuk e kalon një faqe, si psh *Vendimi nr.2, datë 15.02.2010, Vendimi nr.55, datë 25.01.2010, Vendimi nr.230, datë 18.06.2010, Vendimi nr.1279, datë 04.11.2010.*

Në Gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës vetëm një rast është evidentuar për mungesë legjitimimi, për një vendim pushimi duke arugmentuar se nuk është per personi i dëmtuar ai i cili duhet të kundërshtojë vendimin e prokurorisë në Gjykatë.

3.3.5 Ankimimet e vendimeve gjyqësore

Nga studimi i vendimeve në Gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës, rezulton se 15 vendimetë kësaj gjykate për mosfillim të procedimit penal janë ankimuar në Gjykatën e Apelit të Durrësit. Ndërsa për vendimet e pushimit janë ankimuar në Gjykatën e Apelit të Durrësit gjithsej 17 vendime.


Studimi ka shkuar më tej për të parë ecurinë në Gjykatën e Lartë të këtyre çështjeve. Për periudhën e monitoruar, ka rezultuar se asnjë nga vendimet e Gjykatës së Apelit të Durrësit për mosfillim apo pushim nuk është bërë recurs.

Nga monitorimi në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, rezulton se vendimet e gjykatës së shkallës së parë janë ankimuar në të treja

shkallët. Koncretisht, 42 vendime me objekt kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të prokurorisë janë ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë. Për 41 vendime të Gjykatës së Apelit për mosfillimin e procedimit penal është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.

Ndërsa, për vendimet me objekt kundërshtimin e vendimit të pushimit të prokurorisë kemi 75 vendime të Gjykatës së Tiranës, të ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe për 74 prej tyre është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.

Pra rezulton, se vendimet e gjykatës me objekt kundërshtimin e vendimeve të pushimit të prokurorisë janë ankimuar në 88% të tyre, ndërsa, vendimet me objekt kundërshtimin e vendimeve të mosfillimit të prokurorisë janë ankimuar në 30% të tyre.



Grafiku 17 – Të dhëna mbi vendimet e ankimuar në Gjykatat e Apelit Tiranë dhe Durrës dhe Gjykatën e Lartë

Ajo që evidentohet mjaft qartë, është se në të gjitha rastet kur gjykata e shkallës së parë ka pushuar çështjen me objekt kundërshtimin e vendimeve të prokurorisë, gjykata e apelit ka vendosur prishjen e vendimit të pushimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallën e parë.

3.4 Legjitimimi i palëve për kundërshtimin e vendimeve të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal – Rast litigimi strategjik

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, duke patur sensibilitetin për rastet e torturës dhe keqtrajtimit në institucione e paraburgimit, burgje dhe komisariate ka ndërmarë për përfaqësim si rast të litigimit strategjik rastin e të ndjerit Sh.K i cili vdiq në ambjentet e institucionit të Qendrës Spitalore të Burgjeve. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, regjistroi procedimin penal nëdatë 24.02.2011, bazuar mbi kallëzimin penal të ardhur nga Komisarjati i Policisë nr.4 Tiranë mbi vdekjen e Sh.K. Pavarësisht se Prokuroria e Tiranës, kreu një sërë veprimesh hetimore për rastin, në përfundim të hetimeve, me vendim të datës 13.04.2011 vendosi mosfillimin e procedimit penal. Kundër këtij vendimi, vëllai i viktimës i përfaqësuar me avokatë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, bëri ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁴, duke kërkuar prishjen e vendimit dhe vazhdimin e hetimeve.

Me vendimin nr. 956, datë 20.10.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi rrëzimin e kërkesës së vëllait të të ndjerit me argumentimin si i pabazuar në ligj për shkak të moslegjitimit të tij për të ushtruar ankim për kundërshtimin e vendimit të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal.

Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr.487, datë 20.04.2012 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga ana e ankuesit, u paraqit rekurs në Gjykatën e Lartë⁵, e cila me vendimin e Dhomës së Këshillimit të datës 23.01.2014 vendosi mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmban një nga shkaqet që janë të parashikuara në nenin 432 i Kodit të Procedurës penale.

⁴ Cështja në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë dhe atë të Apelit, u përfaqësua nga av. Etilda Gjonaj (Saliu) dhe av. Erida Skendaj, përfaqësuese ligjore të autorizuara nga KSHH

⁵ Rekursi u përkatit me ekspertizën e av. Artan Hoxha dhe av. Etilda Gjonaj (Saliu), përfaqësues ligjor të autorizuar nga KSHH

Pavarësisht se Gjykata e Lartë nëpërmjet dhomës së këshillimit nuk e pranoi rekursin e bërë, çështja është në proces dërgimi në Gjykatën Kushtetuese me objekt të shkeljes së parimit të procesit të rregullt ligjor.

Argumentat që u ngritën në Gjykatën e Lartë, pjesë të rekursit të paraqitur pranë kësaj gjykate, lidhur me këtë çështje përsa i përket kundërshtimit të vendimit të mosfillimit të prokurorisë dhe për legjitimitimin e vëllait të të ndjerit u paraqitën në dy aspekte, atë procedural dhe atë të thelbit të çështjes.

Në opinionin tonë, gjykatat e Tiranës dhe ajo e Apelit e kanë interpretuar dhe zbatuar njëkohësisht në mënyrë të gabuar e në kundërshtim me ligjin, konkretisht nenet 58, 290, 291 dhe 329 të K.Pr.Penale. Në arsyetimin e tyre të dy gjykatat kanë pranuar se kërkuese, vëllai i të ndjerit ShKnuk legjitimohet të bëjë ankim kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, pasi nuk rezultoi të jetë personi që ka bërë kallëzim për veprën penale. Në vendimmarrjen e tyre gjykatat e faktit kanë interpretuar e zbatuar në mënyrë të ngushtë, literale dhe në një interpretim kufizues parashikimet e nenit 291 të K.Pr.Penale.

Kjo dispozitë parashikon se: *“Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit.”*

Ashtu siç kanë pranuar edhe dy gjykatat e faktit, është e vërtetë se në interpretimin e saj literal dispozita e mësipërme në paragrafin e dytë të saj, përcakton si rreth të subjekteve të legjitimuara për kundërshtimin e vendimit të mosfillimit *personat që kanë bërë kallëzim ose ankim*. Megjithatë, gjykatat në interpretimin e tyre kanë dështuar në dhënien kuptim të dispozitës së mësipërme dhe bërjen e saj të zbatueshme.

Të dy gjykatat, në përcaktimin e rrethit të personave të legjitimuar, janë mjaftuar në interpretimin e ngushtë të nenit 291/2 të K.Pr.Penale, duke mos marrë në konsideratë parashikimet e nenit 58 të K.Pr.Penale, si dhe parimet e përgjithshme të procedimit penal. Gjykatat kanë harruar qëllimin kryesor të ligjit procedural penal, parashikuar nga vetë neni 1 i K.Pr.Penale, i cili është garantimi i një procedimi të drejtë, si për personin që dyshohet apo akuzohet se ka kryer veprën penale,

ashtu edhe për personin e dëmtuar nga vepra penale.

Me procedimin dhe më pas ndëshkimin e autorit të veprës penale, ligji synon të garantojë sigurinë e shtetasve dhe rivendosjen e të drejtave të tyre të cënuara, duke u proceduar penalisht personi që ka kryer veprën penale. Pikërisht për këtë arsye, megjithëse njeh dhe ngarkon një organ të posaçëm procedues për ushtrimin e ndjekjes penale, ligji procedural në dispozitat e tij u ka njohur personave të dëmtuar nga vepra penale mundësinë që të kenë një sërë të drejtash procedurale dhe të jenë pjesë e procedimit penal.

Kështu, neni 58 i K.Pr.Penale, si një dispozitë e përgjithshme e këtij ligji, jo vetëm njeh si një nga subjektet e procedimit penal të dëmtuarin nga vepra penale dhe trashëgimtarët e tij, por parashikon edhe të drejtat procedurale të këtyre subjekteve. Kjo dispozitë është edhe baza e të gjitha të drejtave procedurale të të dëmtuarit nga vepra penale dhe familjarëve të tij, të drejta këto që në disa raste janë të përcaktuara shprehimisht në ligj, e në raste të tjera është detyrë e gjykatës t'i përcaktojë rast pas rasti.

Në argumentimet e paraqitura pranë Gjykatës së Lartë, kemi evidentuar faktin se kërkuesi nuk ka bërë kallëzim për veprën penale të vrasjes apo mjekimit të pakujdesshëm ndaj vëllait të tij, por referimi i veprës penale ishte bërë ndërkohë nga vetë Komisariati i Policisë nr.4 Tiranë. Në kushtet kur kallëzimi ekzistonte dhe procedimi penal kishte filluar, pasi organi i akuzës ishte duke kryer veprime procedurale, kallëzimi nga ana e ankuesit apo secilit prej familjarëve të të ndjerit do të ishte i panevojshëm, e madje i pavlerë.

Gjykatat, si organet e ngarkuara nga ligji për interpretimin dhe zbatimin e ligjit në dhënien e drejtësisë, kanë detyrimin ligjor të interpretojnë e zbatojnë dispozitat në harmoni me njëra-tjetrën dhe në mënyrën që garanton sa më shumë të drejta për subjektet e procedimit penal dhe jo siç ka ndodhur në rastin konkret, duke ngushtuar e mohuar këto të drejta.

Në zbatimin e ligjit, gjykata e Tiranës, ajo e Apelit dhe vetë Gjykata e Lartë, kanë dështuar në interpretimin sistematik të neneve 1, 58 e 291 të K.Pr.Penale, megjithëse këto dispozita kanë lidhje integrale me njëra-tjetrën, madje rrjedhin nga njëra-tjetra.

Kështu, e drejta e ankimit ndaj vendimit të mosfillimit të prokurorit,

nuk është gjë tjetër vecse një prej të drejtave procedurale të të dëmtuarit nga vepra penale apo trashëgimtarëve të tij, njohur dhe garantuar nga neni 58/3 i K.Pr.Penale. Duke bërë një interpretim sistematik të pikës 3 të nenit 58 të K.Pr.Penale dhe nenit 291/2 të tij, gjykatat do të arrinin në përfundimin e logjikshëm e ligjor se ndërkohë që ligji i njeh të dëmtuarit nga vepra penale dhe trashëgimtarëve të tij të drejtën për të parashtruar kërkesa përpara organit procedues dhe të drejtën për të kërkuar marrjen e provave (neni 58/3), do të ishte e pakuptimtë dhe në kundërshtim me frymën e ligjit që ai t'u mohojë atyre të drejtën e ankimit ndaj një vendimi të organit procedues për mosfillimin e procedimit që i jep zgjidhje vetë procedimit.

Gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë në vendimmarrjen e tyre as interpretimin historik të dispozitave, moment në të cilin do të kishin konstatuar se paragrafi i tretë i nenit 58 të K.Pr.Penale është një parashikim i shtuar në ligjin penal, me ndryshimet që i janë bërë atij me ligjin nr.8813, datë 13.06.2002. Me shtesën e këtij paragrafi, ligjvënësi ka dashur të shtojë të drejtat procedurale të të dëmtuarit nga vepra penale dhe trashëgimtarëve të tij dhe në kushtet kur neni 58 është një dispozitë me karakter të përgjithshëm, të gjitha dispozitat e tjera që parashikojnë të drejta procedurale të rrjedhura prej këtij neni, sic është edhe neni 291 i K.Pr.P., duhet domosdoshmërisht të interpretohen në frymën e tij.

Pranimi i së kundërtës çon në një situatë juridike e faktike absurde, jo vetëm për faktin se bën të vijnë në kundërshtim parashikimet e nenit 58, paragrafet 1 dhe 3 me ato të nenit 291/2, por edhe për faktin se në rastin konkret bën që ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e ndjekjes penale, praktikisht të mos ketë asnjë person që mund të ushtrojë ankim. Kjo pasi është e qartë dhe afërmendsh që Komisariati i Policisë që ka bërë kallëzimin nuk tërheq asnjë interes për të kundërshtuar vendimin e prokurorit.

Ndryshe nga sa ka pranuar Gjykata e Tiranës, kërkuesi, si një nga trashëgimtarët e të ndjerit, nuk ka vetëm qëndrim emocional ndaj situatës, por ai ka një interes të drejtëpërdrejtë e të ligjshëm për vazhdimin e procedimit penal për vdekjen e vëllait të tij. Nëse pretendimet e tij lidhur me këtë fakt qëndrojnë ose jo dhe nëse ekzistojnë kushtet për vazhdimin e veprimeve hetimore nga ana e

organit të akuzës, është një çështje që i takon të shprehet gjykatës, pas marrjes në shqyrtim të kërkesës për prishjen e vendimit të mosfillimit. Pranimi i së kundërtës do të bënte që çdo vendim mosfillimi i prokurorit në kushtet e nisjes së procedimit mbi bazën e kallëzimit të një insitucioni siç është Komisarati, apo mbi nisjen e procedimit kryesisht (e drejtë e organit të prokurorisë), do të ishte vendim i formës së prerë dhe i paankimueshëm, pasi asnjë prej personave që kanë interes, madje as vetë i dëmtuari nga vepra penale edhe nëse është gjallë, nuk do të legjitimohej në ankimin e një vendimi të tij.

Ky interpretim i nenit 291/2 të K.Pr.P. nga ana e gjykatave të faktit vjen në kundërshtim jo vetëm me parashikimet e nenit 58 të K.Pr.P., por edhe me vetë frymën e ligjit procedural penal dhe qëllimin e ligjvënësit në parashikimet e këtij ligji, duke cënuar të drejtën kushtetuese të aksesit në gjykatë, si një ndër të drejtat themelore të njeriut, garantuar nga neni 42ç2 të Kushtetues dhe neni 6/1 i KEDNJ.

Nga ana tjetër, me interpretimin e tyre gjykatat e faktit kanë krijuar një situatë absurde pabarazie. Të dy gjykatat në vendimet e tyre kanë bërë krahasimin mes subjekteve të legjitimuar sipas nenit 329 të K.Pr.P dhe nenit 291 të K.Pr.P., duke arritur në përfundimin se ligjvënësi i ka diferencuar subjektet që kanë të drejtën e ankimit ndaj vendimit të prokurorit në këto dy raste. Një interpretim i tillë vjen në kundërshtim me vetë parashikimet e ligjit procedural penale dhe frymën e tij. Kujtojmë se si vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, ashtu edhe vendimi i pushimit, pavarësisht se i referohen rasteve të ndryshme, sjellin të njëjtën pasojë juridike, që është mosvazhdimi i procedimit penal.

Duke i konsideruar këto vendime si vendime të ankimueshme në gjykatë, ligji procedural ka parashikuar mundësinë e personave që kanë interes për vazhdimin e procedimit që t'i ankimojnë këto vendime, duke ia lënë gjykatës vlerësimin nëse prokurori i ka ezauruar të gjitha veprimet e mundshme procedurale, apo duhet të vazhdojë hetimin.

Për rrjedhojë, pranimi se neni 329 dhe ai 291 të K.Pr.P., megjithëse cojnë në të njëjtën situatë juridike, legjitimojnë subjekte të ndryshme për ankimin ndaj vendimit të prokurorit, jo vetëm shkakton një pabarazi alogjike mes këtyre subjekteve në një kohë që i dëmtuari

nga vepra penale apo trashëgimtarët e tij, janë subjektet që kanë interes të drejtëpërdrejtë në një rast të tillë, por vjen në kundërshtim edhe me parashikimet e nenit 1 të K.Pr.P. dhe gjithë frymës së ligjit, i cili synon të vendosë e garantojë rregulla të barabarta.

Duke moslegjitimuar ankuesin Fatos Prizreni në kërkimin e tij, gjykatat jo vetëm i kanë mohuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë, por kanë legjitimuar veprimet e paligjshme të prokurorit, madje kanë vendosur një standard të ri: që cdo vendim mosfillimi i prokurorit, sado i paligjshëm apo absurd të jetë, është i paprekshëm e i pacënueshëm, pasi personat që nuk kanë bërë kallëzim penal, nuk mund ta ankimojnë atë. Ky standard sipas gjykatave të faktit duhet të zbatohet në cdo rast, përfshirë edhe rastin kur organi i akuzës mund të fillojë kryesisht një procedim penal.

Ky përfundim i gabuar do të çonte në krijimin e dy standarteve diametralisht të ndryshme për të trajtimin juridik të të njëjtin subjekt, *të dëmtuarin nga vepra penale*, për të njëjtin shkak e me të njëjtën pasojë. Kjo bie ndesh me të gjithë korpusin e normave të Kodit të Procedurës Penale dhe në vecanti, me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga KEDNJ dhe Kushtetuta e R. Shqipërisë.

Argumenti i dytë që u paraqit nëpërmjet rekursit në Gjykatë të lartë, ishte se bazuar mbi përfundimin e parë të tyre, duke moslegjitimuar kërkuesin, në ankimin ndaj vendimit të prokurorit, gjykatat nuk kanë marrë në shqyrtim as pretendimin e tij për mosfillimin e procedimit penal, pasi edhe nëse përfundimet e tij do të ishin të bazuara, referuar dispozitave të K.Pr.P., duhej vendosur pushimi i procedimit dhe jo mosfillimi i tij.

Nëse do t'i referoheshim vetë arsytimit të prokurorit në vendimin e mosfillimit, rezulton se ai ka kryer një sërë veprimesh procedurale e hetimore përpara marrjes së këtij vendimi, si: kqyrje e vendit të ngjarjes, kqyrje e dokumentave, kqyrje e kufomës, marrja dhe administrimi i kartelës klinike, pyetja e deklaruësve të shtetasve, dhe pas kryerjes së këtyre veprimeve, ai ka arritur në konkluzionin se vepra penale nuk ekziston, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal. Gjithashtu Prokurori i çështjes ka shkuar më tej duke kërkuar të bëhet një akt ekspertimi

Një përfundim i tillë i prokurorit vjen në kundërshtim me nenet 290

e 291 të K.Pr.P., pasi neni 291 është një dispozitë që referon tek neni 290, duke përcaktuar se mosfillimi i procedimit vendoset në ato raste kur “ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit”. Rrethana të tilla përcaktohen nga neni 290 i K.Pr.P.

Siç është pranuar edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në një sërë vendimesh të tij, rasti i marrjes nga ana e prokurorit të vendimit të mosfillimit i referohet një situatë juridike të ndryshme nga rasti i marrjes së vendimit të pushimit, pavarësisht shkaqeve për të cilat arrihet në një përfundim të tillë.

Kështu, mosfillimi i procedimit i referohet një situatë kur vërtetohen fakte të tilla, të cilat ndalojnë fillimin e procedimit penal që në hapat e tij të parë. Ndërkohë që pushimi i procedimit i referohet rasteve kur faktet për të cilat procedimi nuk mund të vazhdojë apo nuk duhet të kishte filluar vërtetohen gjatë hetimit, pra pasi prokurori ka ndërmarre veprime hetimore e procedurale.

Në rastin konkret, rezulton e qartë se prokurori ka kryer një sërë veprimesh hetimore, cka do të thotë se edhe nëse përfundimi i tij do të ishte i drejtë, ai duhet të kishte arritur në përfundimin e pushimit të procedimit dhe jo mosfillimit të tij.

E përmendim këtë fakt thjesht dhe vetëm për të vërtetuar qëndrimin kufizues të gjykatave lidhur me rastin në shqyrtim. Pasi nëse do të kishin vullnetin për t’i garantuar të drejtat procedurale kërkuesi, këto gjykata mund të kishin shqyrtuar pretendimin e tij lidhur me gabimin e prokurorit në vendimmarjen e tij për mosfillimin e procedimit. Duke konstatuar se ndodhemi përpara rastit të pushimit të procedimit, referuar vetë interpretimit të gjykatave të faktit për nenin 329 të K.Pr.P., megjithëse i pabazuar në ligj, ankuesi do të ishte një subjekt i legjitimuar në proces. Në të kundërt, gjykatat janë mjaftuar me mohimin e askesit të kërkuesit në gjykatë si një person i palegjitimuar duke i hequr kështu në kundërshtim me ligjin të drejtën për tu ankuar.

Për periudhën objekt monitorimi, lidhur me legjitimitimin janë kthyer vendime për hetim nga Gjykata e Apelit vetëm për mosfillim të procedimit penal në dy raste gjithsej, një për vitin 2009, dhe një për vitin 2010, dhe asnjë në asnjë rast për pushim të hetimit.

KREU 4

PROCEDURAT DHE AFATET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE ME BURGIM DHE MASAT MJEKËSORE DHE EDUKUESE

Ashtu siç e kemi përmëndur dhe në hyrje të këtij studimi, objekti i monitorimit tonë dhe interes për studim kanë patur edhe ekzekutimet e vendimeve penale me burgim, masat mjekësore dhe masat edukuese të dhëna nga gjykata. Ky studim u shtri jo vetëm në prokuroritë e rretheve gjyqësor objekt monitorimi por edhe në Gjykatat Tiranë dhe Durrës.

Për periudhën objekt monitorimi, në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës janë studiuar urdhrat ekzekutimi për 300 vendimet gjyqësore me burg. Ndërsa në Prokurorinë e Tiranës janë studiuar urdhrat e ekzekutimit për 343 vendime gjyqësore me burg. Ndërsa në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë u studiuan 900 vendime gjyqësore me dënim me burg, ndërsa në Gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës u studiuan 443 vendime.

4.1 Mbajtja e dokumentacionit në prokuroritë dhe gjykatat e monitoruara

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, dokumentacioni mbahej në zyrën e prokurorit të ekzekutimeve, në dollape prej hekuri dhe të mbyllur me çelës. Ato mbaheshin në kushte të mira, vendi ishte i thatë pa lagështirë, dhe me dritë. Dosjet ishin të ruajtura në mënyrë manuale dhe nuk disponoheshin në mënyrë elektronike. Aksesimi i dokumentacionit u bë manualisht duke u ekzaminuar rast pas rasti.

Në Prokurorinë e Rrethit gjyqësor Tiranë, u vu re se dokumentacioni që u konsultua dhe u studiuva ruhej në zyrën e sekretarisë së

ekzekutimit të vendimeve penale dhe në arkiva. Kushtet fizike dhe ato për ruajtjen e sigurisë së dosjeve ishin të mira. Dosjet ishin të rënditur sipas një rendi kronologjik në mënyrë manuale. Database të të dhënave kishte pranë zyrës së sekretarisë së ekzekutimit të vendimeve penale. Grupi i monitorimit të KSHH-së, nuk e konsultoi këtë database për arsye të sigurisë së të dhënave që ishin aty.

Ndërsa në Gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës, vendi se ku mbahej dokumentacioni ishte arkiva, e cila e cila ishte e ndarë në tre ambiente të ndryshme. Me gjithë përkushtimin e stafit administrativ të gjykatës për të patur një punë sa më efektive, kushtet në të cilat ndodhej arkiva nuk lejonin një produktivitet maksimal për realizimin eficient të punës administrative të gjykatës si edhe për monitorimin nga ana jonë. Dosjet dhe regjistrat ishin të ruajtura në rend kronologjik. Nxjerrja e informacionit objekt studimi nga dosjet dhe regjistrat u bë në mënyrë manuale, pasi nuk disponohej një database i të dhënave dhe nuk ishin të ruajtura në rrugë elektronike.

Në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tirane, vendimet e formës se prerë mbaheshin në enyrë të sistemuar kronologjikisht, të ndara në vite, konkretisht librat e dorëzimit të dosjeve dhe regjistri i numërtimeve, të sistemuara dhe në kushte të mira fizike. Database e gjykatës ku hidheshin dhe mbaheshin elektronikisht të dhënat lidhur me kronologjinë e seancave gjyqësore, bënte të mundur identifikimin e statusit të çështjeve penale mbi bazën e dispozitave ligjore, gjyqtarët që i gjykonin, prokurorët, të pandehurit, etj., mundësohej aksesimi i vendimeve penale të dhëna nga kjo gjykatë dhe shikohej nëse vendimi ishte ankimuar. Hapësira e arshivës penale ku ruheshin dosjet përkatëse ishte e vogël dhe e pamjaftueshme në objektet si rafta, etj. Gjithashtu ajo që u vu re ishte se kishte nevojë për një sistemim sipas numrave të vendimit, të ndara në vite me qëllim gjetjen më lehtë të tyre.

Megjithatë aksesin në sistem nuk mjaftoi për të marrë të gjithë informacionin e duhur për përpunimin statistikor, për këtë arsye u kontrolluan rregjistrat përkatës.

4.2 Të dhënat sasiore nga Gjykata.


Në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, u studiuan për periudhën korrik 2009 – qershor 2010, 900 vendime gjyqësore me burgim, ndër të cilat 390 vendime i përkisnin 6 mujorit të dytë të vitit 2009 dhe 510 i përkisnin gjashtëmujorit të parë të vitit 2010.

Sa më poshtë në tabelë po paraqesim dispozitivin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë se ç'kanë vendosur lidhur me çështjet e gjykuara.

Përshkrim i vendimeve	Gjashte-mujori i dytë i vitit 2009	Gjashtë -mujori i parë i vitit 2010
Pafajësi	14	25
Përjashtim gjykimi	1	-
Pushim çështje	2	15
Dënim i barabartë me paraburgimin	15	3
Dënim më i ulët se paraburgimi	1	1
Dënim tjetër më i butë	6	-
Dënim më i madh se paraburgimi	351	466
Total vendime	390	510

Ndërsa në Gjykatën e rrethit gjyqësor Durrës, për periudhën objekt studimi rezultojnë gjithsej 138 vendime, prej të cilave 63 për vitin 2009 dhe 75 për vitin 2010. Nga 63 vendime të vitit 2009, 4 vendime janë dhënë për dënim të barabartë, 2 dënime më të ulta, si dhe 57 vendime për dënime të tjera më të buta. Për vitin 2010 nga 75 vendime, 5 janë vendim i barabartë, 2 dënime më i ulët si dhe 68 dënimet e tjera ishin më të buta.

Nga monitorimi i dosjeve rezulton se në vitin 2010 kemi patur 4 raste kur prokurori ka kërkuar deklarin fajtor të të pandehurit, ndërsa gjykata i ka shpallur të pafajshëm, përveç një rasti ku Gjykata e Shkallës së Parë ka dhënë pafajësi, prokuroria e ka apelur vendimin dhe Gjykata e Apelit e ka deklaruar të pandehurin fajtor.



Grafiku 18. Llojet e dënimeve të ulta dhe të barabarta të dhëna nga Gjykata e Tiranës dhe e Durrësit

Për sa i perket dënimeve të mësipërme, dukeju referuar nenit 21 i Ligjit Nr.8331, datë 21.4.1998 i ndryshuar “Për Ekzekutimin e Denimeve Penale”, kërkohet ekzekutim i menjëhershëm. Problematikë mbetet në këto raste kur gjykata jep dënim më të ulët ose të butë pasi është evidentuar një mungesë koordinimi midis gjykatës dhe prokurorisë me qëllim që personi të lirohet menjëherë, nëpërmjet ekzekutimit të menjëhershëm.

4.3 Afatet e respektuara për arsyetimin e vendimeve gjyqësore nga gjykatat

Ajo për të cilën shpeshherë diskutohet me qëllim ekzekutimin e menjëhershëm ose të shpejtë të vendimit nga ana e Prokurorisë është zbardhja e menjëhershme e vendimit të gjykatës, pavarësisht mundësisë së marrjes së vendimit të shkurtuar.


Lidhur me vendimet e Gjykatës së rrethit gjyqësor Durrës, rezulton se është bërë zbardhja e vendimeve me një afat kohor prej tre ditësh për 24 vendime, 4-10 ditë për 251 vendime, deri në 15 ditë për 70 vendime, deri në 30 ditë për 55 vendime, më shumë se 30 ditë për 17

vendime.

Në të njëjtën situatë paraqiten dhe ato vendime me ekzekutim të menjëhershëm, brënda 3 ditëve nga shpallja 6 vendime, 95 vendime brënda 4-10 ditë, 55 vendime, zbardhja e të cilave është bërë që nga shpallja e vendimit deri në publikim e tij të arsyetuar për vendimet me ekzekutim të menjëhershëm dhe ka zgjatur më shumë se 10 ditë.

Ndërsa përsa i përket Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë na rezulton se deri në 3 ditë janë arsyetuar 41 vendime, nga 4 – 10 ditë për 144 vendime, deri në 15 ditë 69 vendime gjyqësore, deri në 30 ditë 73 vendime, dhe për më shumë se 30 ditë janë arsyetuar 58 vendime gjyqësore.

Nga konsultimi me librat e dorëzimit të dosjeve me vendimet e zbardhura rezultoi se, shumë nga ato ishin dorëzuar pasi kishte kaluar afati i ankimit. Kishte dosje të cilat ishin dorëzuar mbi 40 ditë nga dita e shpalljes së vendimit. Një rast ku vendimi kishte marrë formë të prerë, pa u ankimuar, dosja gjyqësore penale ishte dorëzuar në sekretari pas 74 ditëve.



Grafiku 19. Afatet kohore për arsyetimin e vendimeve gjyqësore të Gjykata respektive

4.4 Afatet e respektuara për dërgimin e vendimeve nga sekretaria gjyqësore drejtuar prokurorisë

Për periudhën objekt monitorimi për sa i takon afateve që janë zbatuar nga sekretaria e gjykatës për t'ia dërguar vendimin penal prokurorisë së rrethit për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së rrethit gjyqësor Durrës, objekt monitorimi kanë rezultuar 327 vendime, prej të cilave për 2 vendime afati kohor nuk mund të llogaritet për shkak të mangësive që evidentuam në regjistra.

Konkretisht për vitin 2009, kanë qënë 131 vendime prej të cilave:

- 2 vendime rezultojnë menjëherë pas shpalljes së vendimit,
- 24 vendime brënda 3 ditëve nga shpallja,
- 16 vendime brënda afatit 4-10 ditë,
- 89 vendime rezultojnë në një afat kohor më shumë se 10 ditësh.

Ndërsa për vitin 2010, rezultojnë:

- 139 vendime me afat kohor më shumë se 10 ditë,
- 38 vendime me afat 4-10 ditë,
- 17 vendime brënda 3 ditëve nga shpallja,
- asnjë vendim nuk rezulton me afat kohor menjëherë pas shpalljes së vendimit.

Përsa i përket afatit që është zbatuar nga Sekretaria e Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë për të dërguar vendimin penal Prokurorisë së rrethit për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë së prerë së shprehursi më poshtë:

Për 6 mujorin e dytë të vitit 2009 rezulton se:

- 1 vendim është dërguar menjëherë pas shpalljes së vendimit
- 101 vendime brenda 3 ditëve nga shpallja \
- Për 79 vendime nga 4 – 10 ditë
- Më shumë se 10 ditë është për 203 vendime gjyqësore

Për 6 mujorin e parë të vitit 2010, rezulton sa më poshtë:

- Brenda 3 ditëve nga shpallja për 158 vendime gjyqësore
- Për 4 – 10 ditë është bërë për 89 vendime gjyqësore
- Më shumë se 10 ditë në 263 raste ose vendime gjyqësore

Vështirësia në evidentimin e të dhënave të mësipërme ka qënë e madhe, për shkak se në asnjë dosje ose regjistër ishte e shënuar data

e zbardhjes së vendimit të arsyetuar. Për këtë arsye si datë e zbardhjes së vendimit u mor data e dorë zimit të dosjes gjyqësore penale nga ana e sekretares së gjyqtarit në kryesekretari, datë e shënuar në librat e dorëzimit, si dhe në regjistrin e numërtimeve.

Ndërsa përsa i përket dërgimit të vendimeve për ekzekutim nga sekretaria e gjykatës drejtuar prokurorisë, shënohej data e dërgimit në libër të veçantë protokolli, gjithashtu kjo datë përgjithësisht përputhej me datën e marrë në dorëzim të vendimit formë e prerë nga ana e kryesekretares, e shënuar në fund të vendimit.

4.5 Urdhurat e ekzekutimit të organit të akuzës dhe afatet e ndjekura

Nga monitorimi i urdhrave të ekzekutimit të prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë dhe asaj Durrës, rezultoi se në përgjithësi kishte mungesë informacioni nga urdhërat e ekzekutimit për rastet e ekzekutimit të menjëhershëm sidomos në Tiranë.

Ajo që u evidentua si problematikë ishte se për vendimet me ekzekutim të menjëhershëm, jo në gjitha rastet Prokuroria e ka lëshuar menjëherë urdhërin e ekzekutimit.

Lidhur me vendimet me ekzekutim të menjëhershëm, është evidentuar mosrespektimi i dispozitës ligjore brenda ditës. Në më shumë se gjysmat e vendimeve, ka rezultuar se urdhëri i ekzekutimit është lëshuar pas 2 deri në 4 ditë.


Konkretisht në Prokurorinë e rrethit gjyqësor të Durrësit është evidentuar:

- Për vitin 2009, urdhërat e ekzekutimit janë nxjerrë menjëherë pas shpalljes së vendimit për 5 vendime; brënda 3 ditëve nga shpallja e vendimit në 31 çështje; afatin 4 deri në 10 ditë nga shpallja për 54 vendime, deri në 15 ditë për 14 vendime, deri në 30 ditë janë 9 vendime si dhe në më shumë se 30 ditë janë 26 vendime.
- Për vitin 2010 janë: menjëherë pas shpalljes së vendimit nuk ka asnjë vendim, brënda 3 ditëve nga shpallja janë 19 vendime, 4 deri në 10 ditë janë 18 vendime, deri në 15 ditë janë 3 vendime, deri në 30 ditë janë 5 vendime si dhe në më shumë se 30 ditë janë 18 vendime.

Gjatë monitorimit të dokumentacionit përkatës në Prokuroritë e rretheve gjyqësore Tiranë dhe Durrës, një vëmendje i kushtuam dhe afateve të ndarë sipas subjekteve, personat me masë sigurie dhe personat në gjëndje të lirë. Kjo pasi për personat me masë sigurie arrest me burg ose alternative të tjera, vonesat në nxjerrjen e urdhërave të ekzekutimit janë me pasoja.

Afatet që janë ndjekur nga Prokuroria e rrethit gjyqësor Durrës për nxjerrjen e urdhërave të ekzekutimit në rastet kur personat janë të arrestuar ka rezultuar se sapo vendimi ka marrë formë të prerë vetëm në 27 raste, dhe më shumë se 3 ditë për 10 vendime.


Ndërsa përsa i përket Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë, për nxjerrjen e urdhërave të ekzekutimit në rastet kur personat kanë qënë të arrestuar janë ndjekur afate më të gjata se prokuroria e Durrësit. Më shumë urdhëra ekzekutimi nga shpallja e vendimit janë për një afat për më shumë se tre ditë, konkretisht 98 raste dhe më pak janë ato urdhëra ekzekutimi të menjëhershme ose brenda 48 orëve.



Grafiku 20 – Paraqitje grafike lidhur me nxjerrjen e urdhërave të ekzekutimit sipas afateve kohore sa më sipër, për personat me masë sigurie

Nga Prokuroria e Durrësit për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit në rastet kur personat nuk janë të arrestuar rezulton se në shumtën e rasteve është respektuar afati 48 orë nga shpallja e vendimit për 49 vendime, por nuk mungojnë dhe ato raste kur urdhërat e ekzekutimit janë nxjerrë për një afat më shumë se tre ditë ashtu si dhe ato menjëherë pasi ka marrë formë të prerë (për 32 vendime).

Ndërsa nga Prokuroria e Tiranës, për nxjerrjen e urdhërave të ekzekutimit janë ndjekur afatet për më shumë se tre ditë në rreth 97 vendime, dhe më pak në mënyrë të menjëhershme, duke bërë dallim të dukshëm me Prokurorinë e rrethit gjyqësor të Durrësit.



Grafiku 21. Paraqitje grafike lidhur me nxjerrjen e urdhërave të ekzekutimit sipas afateve kohore sa më sipër, per personat që janë gjykuar në gjëndje të lirë, pa masë sigurie

Lidhur me përmbajtjen e urdhërave të ekzekutimit të organit të prokurorisë, u evidentua se në përgjithësi janë të plota dhe të sakta, duke përshkruar qartë vendimin penal që vihet nën ekzekutim, identiteti i të dënuarit, vendndodhja e tij, lloji dhe masa e dënimit kryesor që do të vuhet efektivisht, lloji i dënimit plotësues dhe kriteret e zbatimit të tij, detyrimi civil, organet që do të ekzekutojnë ose mbikqyrin ekzekutimin. Për rastet kur personat kanë qënë në

paraburgim me masë arresti në burg atyre u është llogaritur koha e vuajtur dhe pjesa e mbetur e dënimit që ata duhet të kryejnë. Në urdhërat e ekzekutimit përcaktohet vendi i ekzekutimit të personave, gjithashtu edhe për rastet kur kanë qënë në paraburgim përcaktohet vendi se ku ato kanë qënë dhe vendi se ku do kryejnë pjesën e mbetur të dënimit.

Nga monitorimi, rezultoi se për çdo lloj dënimi, kryesor ose plotësues, nxirrej një urdhër ekzekutimi i veçantë, d.m.th. vetëm për ekzekutimin e atij lloji të dënimit.

Në rast se i dënuari ndodhej në paraburgim dhe urdhëri i ekzekutimit i dërgohej për ekzekutim autoriteteve të paraburgimit. Nëse i dënuari ishte në gjendje të lirë atëherë urdhëri i ekzekutimit i dërgohej organeve të policisë të cilat kishin për detyrë ekzekutimin e këtij urdhëri. Kur arrestonin të dënuarin nxirrej urdhëri i arrestit dhe më pas urdhëri i transferimit për në IEVP ku do të vuhej dënimi.

Ashtu si në Prokurorinë e Rrethit gjyqësor Tiranë dhe atë të Durrësit, urdhërat e ekzekutimit gjatë periudhës së monitorimit janë ekzekutuar të gjitha në mënyrë të detyrueshme, nuk rezulton asnjë urdhër ekzekutimi në mënyrë vullnetare.

Lidhur me njoftimin e personave për ekzekutimin e vendimit, pothuajse në çdo rast është respektuar afati 30 ditor. Gjatë monitorimit kemi pasur vetëm një rast kur personi ka qënë i mitur dhe nuk është bërë njoftimi i prindërve, evidentuar kjo në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës⁶. Në çdo rast evidentohet qartë në regjistrin e ekzekutimeve dhe në urdhër ekzekutimin e nxjerrë nga prokuroria njoftimi i palëve nga ana e prokurorisë, si dhe procedurat e bërjes së njoftimit.


4.6 Ekzekutim i masave mjekësore dhe edukuese

Një vëmendje të veçantë në këtë monitorim kishin dhe masat mjekësore dhe edukuese të dhëna me vendim gjyqësor dhe se si ishte bërë ekzekutimi i tyre nga organi i prokurorisë.

Nga Gjykatat e rrethit gjyqësor Tiranë dhe Durrës, për periudhën

⁶ *Vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor Durrës, Nr 192, dt 21.06.2010*

objekt monitorimi janë dhënë 38 vendime për masa mjekësore me mjekim të detyruar në një institucion mjekësor dhe 13 masa mjekësore me mjekim ambulator. Sipas nenit 46 të Kodit penal përcaktohet se masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepra penale të cilat janë mjekim i detyruar në një institucion mjekësor dhe mjekim ambulator.




Grafiku 22 – Vendimet gjyqësore për masat mjekësore me mjekim të detyruar dhe ambulator

Gjykata për periudhën objekt monitorimi, në vendimet e saj për masa mjekësore të detyrueshme, ka përcaktuar në mënyrë të gabuar vendin se ku do të ekzekutohet masa në rreth 40% të vendimeve gjyqësore, duke specifikuar kështu institucionin penitenciar si një të tillë, konkretisht ka referuar Qendrën Spitalore të Burgjeve dhe IEVP Zahari Krujë. Për pjesën tjetër ka përcaktuar vetëm se ky vendim duhet të ekzekutohet në një institucion mjekësor ose psikiatrik.

Gjatë periudhës së monitorimit, në Prokurorinë e Durrësit janë lëshuar urdhërat e ekzekutimit për 10 vendime gjykate me masa mjekësore, prej të cilat 5 raste mjekim i detyruar ambulator dhe 5 raste

mjekim i detyruar në një institucion psikiatrik. Në Prokurorinë e Tiranës janë lëshuar urdhrat e ekzekutimit për 6 vendime gjyqësore me masa mjekësore, 4 mjekim i detyruar në Institucion dhe 2 me mjekim ambulator.



Grafiku 23 – Paraqitje grafike për ekzekutimin e masave mjekësore me mjekim të detyruar dhe ambulator nga Prokuroritë e Tiranës dhe Durrësit

Sa i takon urdhrave të ekzekutimit për vendimet me masa mjekësore, për periudhën objekt monitorimi, është përcaktuar vendi i ekzekutimit të masës, më konkretisht, mjekim i detyruar ambulator në një institucion psikiatrik. Ndërsa në të shumtën e rasteve, urdhërat e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për masa mjekësore të detyrueshme referojnë si institucion ku do të ekzekutohet vendimi, një nga institucionet penitenciare si IEVP Zahari Krujë, ose Qendrën Spitalore të Burgjeve.

KSHH nëpërmjet shumë shkresave drejtuar institucioneve shtetërore e ka ngritur dhe adresuar çështjen e ekzekutimit të masave mjekësore të detyrueshme në një institucion mjekësor, por deri tani

nuk ka gjetur zgjidhje. Personat me masa mjekësore në mënyrë të padrejtë vazhdojnë të mbahen në Institucione penitenciare duke përbërë kështu një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut.

Nga monitorimi na ka rezultuar vetëm një vendim i Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë i cili vendoste zbatimin e masës edukuese në një institucion edukues, në zbatim të nenit 46 të Kodit penal dhe atij të Kodit të Procedurës Penale, por pa e përcaktuar atë se ku do të ekzekutohet, kjo për shkak dhe të mungesës së një institucioni të tillë.

5. Konkluzione dhe Rekomandime

Sa më poshtë po paraqesim disa nga konkluzionet më të rëndësishme të dala nga ky studim për secilën çështje të trajtuar si dhe rekomandimet përkatëse, të cilat janë si rezultat jo vetëm I studimit dhe I ekspertëve që kanë marrë pjesë në këtë studim por rekomandime që kanë dalë dhe nga tryeza e rrumbullakët e realizuar në datën 30 janar 2014 falë kontributit me moderimin e tyre aktiv të ekspertëve z. Arben Rakipi dhe z. Artan Hoxha.

I. Lidhur me mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit në Institucionet e monitoruara

Rekomandojmë:

- Krijimin e hapësirave të përshtatshme në të gjitha institucionet e monitoruara për ruajtjen dhe mbajtjen e dokumentacionit përkatës, duke i zgjeruar ato në përputhje me kushtet fizike dhe teknike të duhura dhe duke siguruar baza materiale si raftet, etj.
- Krijimin e një datebase elektronik për të dhënat statistikore, pasi ashtu siç ka rezultuar nga ky studim të dhënat mbahen në mënyrë manuale, pavarësisht se situatë më mirë paraqitet në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë.

- Lidhur me administrimin e dosjeve, sugjerojmë se nga të gjitha instituicionet e monitoruara kërkohet vëmendje të veçantë për përmirësimin e saj jo vetëm në drejtim të infrastrukturës materiale por edhe, në pikëpamje të organizimit që lidhet me indeksimin, regjistrimin në regjistra të veçantë të dosjeve etj.
- Mbajtja e databases bëhet në mënyrë manuale në Prokuroritë e rretheve gjyqësore përkatëse dhe kjo bënte që statistikave që përftohen të mos jenë të sakta. Për këtë arsye sugjerojmë që të merren masa për vendosjen e databasave elektronike me qëllim evidentimin më të mirë të punës, ruajtjes së arshivës dhe nxjerrjes së statistikave.

II. Lidhur me vendimet e “Pushimit” dhe “Mosfillimit” të procedimit penal të Prokurorisë

Konkluzione

- Gjatë studimit ka rezultuar se veprat penale më të cilat më së shumti është vendosur mosfillimi i procedimit penal, janë krimet kundër jetës, kundër lirisë së personit, kundër pronës, shpërdorimit të detyrës, fallsifikimit të dokumentave.
- Gjithashtu, kemi konstatuar se më së rreth 75% të vendimeve janë vendime mosfillimi të vendosura nga prokuroria dhe më pak vendime pushimi.
- Është konstatuar se pavarësisht kompetencave që ju njihet legjislacioni në fuqi, Institucioneve të ndryshme shtetërore për të bërë kallzime në organin e Prokurorisë, në vendimet e studiuara ka rezultuar se vetëm në 8% të rasteve kallzimi është bërë nga Institucionet shtetërore.
- Është konstatuar se në të shumtën e vendimeve të prokurorisë që kanë vendosur mosfillim, janë kryer veprime hetimore të cilat në zbatim të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, s’mund të vendoset mosfillimi i çështjes.
- Edhe pse të pakta në numër janë konstatuar vendime gjyqësore

të paarsyetuara. Ashtu siç janë identifikuar vendime të cilat pavarësisht volumit të faqeve arsyetimi i tyre mbetet i varfër dhe i paargumentuar.

- Nga studimi është vënë re se të dëmtuarit nga veprat penale janë të painformuar lidhur me hapat dhe procedurat që ndiqen nga prokuroria për ecurinë e hetimeve.
- Në vëmendjen e aktivitetit ligjbërës mund të jenë edhe afatet që lidhen me procedurat në rastin e pushimit apo mosfillimit të çështjes penale.
- Një aspekt tjetër që duhet ti kushtohet rëndësi e veçantë është edhe detyrimi i palëve prokurorit, të akuzuarit, të dëmtuarit, për të respektuar procedurat gjyqësore, të kushtëzuara nga prania apo mosprania e tyre në gjykim, të lidhura me vlefshmërinë e veprimeve procedurale gjyqësore në çështjet e kësaj natyre.
- Është evidentaur se palët nuk e kanë shfrytëzuar mundësinë për ankimim tek prokurori më i lartë, mundësi procedurale kjo që nuk mund të evidentohet dot nëse lidhet me mungesën e besimit apo mungesën e njohjes të ligjit.
- Në asnjë rast, nga rastet e monitoruara, në Prokurorinë e Tiranës për vendimet e mosfillimit nuk rezulton të jetë respektuar kërkesa e ligjit procedural, pra njoftimi në mënyrë të menjëhershme. Dhe në rastet kur Prokuroria e Tiranës, ka vendosur pushimin e gjykimit haset e njëjta problematikë. Vetëm se në këto raste ligji procedural nuk përcakton një afat për njoftimin e palëve të interesuara dhe është e vështirë për të dhënë një informacion se kur është bërë njoftimi.
- Lidhur me vendimet e mosfillimit nuk ka afate specifike dhe përgjithësisht janë respektuar afatet e procedimit të çështjes sipas nenit 323 të KPRP-së, për rastet e mosfillimit dhe pushimit të procedimit penal.
- Nga studimi i vendimeve të pushimit na ka rezultuar se më së shumti, se hetimi si kohëzgjatje totale kanë zgjatur për një periudhë 6 – 12 muaj. Dhe jo në të gjitha rastet kjo është shoqëruar në aktet e depozituara me zgjatje të hetimit.
- Nga të dhënat e studiuara na rezulton se në Gjykatën e rrethit

gjqësor Tiranë dhe në atë të Durrësit vetëm në 21% të rasteve, vendimet e prokurorisë janë kundërshtuar nga Institucionet shtetërore që kanë bërë kallzim në prokurori për çështje të evidentuara brenda kompetencave të tyre.

- Rezulton se kohëzgjatja e proceseve gjyqësore në rastet e kundërshtimit të vendimeve të prokurorisë janë tepër të gjata, duke marrë në konsideratë që në çështje të caktuara këto afate shkojnë deri në dy vjet.

Rekomandime

- I rekomandojmë Prokurorisë së Përgjithshme, që të marrë masa përkatëse për kryerjen e hetime të metejshme lidhur me rastet që hetohen nga prokuroritë përkatëse sidomos në ato raste kur janë krime kundër jetës ose vepra të tjera penale, me qëllim shmangien e vendimeve abusive për mosfillimin e procedimit penal.
- I rekomandojmë Prokurorisë së Përgjithshme që të ushtrojë inspektive të herëpashershme tematike me qëllim rishikimin e vendimeve të prokurorive për “Mosfillimin e procedimit penal” dhe vendimet “për pushimin e hetimit”.
- Prokuroria e përgjithshme rekomandojmë që duhet të monitorojë Prokuroritë e rretheve ose nëpërmjet udhëzimeve të brendshme të bëjë të mundur zbatimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në të cilën përcaktohet shprehimisht se në rast se kur kryen veprime hetimore, prokuroria nuk mund të vendosë mosfillim të procedimit penal.
- Do të inkurajonim Këshillin e Ministrave që të mbikqyrë Institucionet në varësi me qëllim ushtrimin e funksionit të tyre sipas ligjit në këndvështrimin e kallzimeve dhe rasteve të referuara prokurorisë kur konstatojnë shkelje të ligjit që përbën një vepër penale.

- Rekomandojmë Drejtuesit e Gjykatave dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë të mbikqyrin vendimet gjyqësore me qëllim që ato të jenë të shpallura dhe të arsyetuara brenda afatit ligjor.
- Në kuadër të Reformës në Drejtësi, sugjerojmë rishikimin e Kodit të Procedurës Penale me qëllim përmirësimin e instituteve që kanë të bëjnë me kushtet e mosfillimit dhe pushimit të çështjes penale, me qëllim përcaktimin e subjekteve të cilat mund të ankimojnë vendimin e prokurorisë për mosfillimin në gjykatë, në këndvështrim të nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale.
- Sugjerojmë përcaktimin në Kodin e Procedurës Penale, të afateve të ankimit (*neni 24ç5 i KPRP-së*) për vendimet e prokurorisë nga Prokuroria e Përgjithshme si dhe përcaktimin drejt të rasteve kur vendimi i Prokurorisë kundërshtohet në Gjykatë dhe në Prokurorinë e Përgjithshme si organ më i lartë hierarkik me qëllim parandalimin e ankimit të dyfishtë.
- Rekomandojmë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtuesve të Prokurorive pranë rretheve gjyqësore, ti kushtojnë vëmendje më të madhe të drejtave procedurale të të dëmtuarve nga vepra penale, krijimit të mundësive për të qenë në dijeni të çdo lloj veprimtarie procedurale, si dhe të reagimit ndaj saj kur vlerësohet në kundërshtim me ligjin material dhe procedural. Duke qenë në dijeni, në vazhdimësi të procedimit, i dëmtuari nga një vepër penale mund të realizojë në çdo kohë, pa asnjë kufizim të drejta të tij kushtetuese që lidhen me përfaqësimin mbrojtjen dhe aksesin në gjykatë etj.
- Rekomandojmë që Prokuroria e Përgjithshme ashtu si dhe Drejtuesit e Prokurorisë të ndërmarrin inspektive të herëpashershme tematike me qëllim për ta bërë më të efektshëm ankimin administrative për shkak të numri të ulët të evidentuar.

- Rekomandojmë parashikimin në Kodin e Procedurës penale të afatit përkatës të njoftimit për vendimet e prokurorisë të pushimit të procedimit penal.
- Rekomandojmë përcaktimin në Kodin e Procedurës Penale të afateve të procedimit që ndjek organi i akuzës për rastet e mosfillimit dhe pushimit të procedimeve penale si dhe me qëllim shmangien e afateve të gjata të procedimit penal, të ushtrohet kontroll i vazhdueshëm nga drejtuesit në nivel hierarkik.
- Rekomandojmë Institucionet shtetërore që të ushtrojnë kompetencat e tyre duke shteruar mjetin e ankimit administrativ dhe atë gjyqësor duke kundërshtuar vendimet e prokurorisë për mosfillimin ose pushimin e procedimit penal por njëkohësisht del e nevojshme të rishikohet evidentimi I shkeljeve dhe I provave që paraqitet pranë prokurorisë.
- Rekomandojmë Këshillit të Lartë të Drejtësisë të ushtrojë kontrole lidhur me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore për kundërshtimin e vendimeve të prokurorisë për shkak dhe të specifikës që kanë këto çështje për të cilat mund të vendoset nga gjykata që të rikthehen për hetime të tjera organit të prokurorisë.
- Rekomandojmë që Gjkata e Lartë, çështjet që paraqiten para saj për kundërshtimin e vendimeve të prokurorisë mos të presin në listë pritje si të gjithë çështjet e tjera por t'u jepet prioritet për shkak se kthimi i tyre me vonesë për hetime të mëtejshme do ta bëjë të vështirë realizimin në praktikë për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.

III. Lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale

Konkluzione

- Moszbardhja Brenda afatit ligjor të vendimeve gjyqësore sidomos sjellin vonesa në nxjerrjen e urdhërave të ekzekutimit nga prokuroria, duke bërë kështu që shpeshherë cënimin e rëndë të të drejtave të njeriut.
- Në më shumë se gjysmat e vendimeve të monitoruara për vendimet me ekzekutim të menjëhershëm, urdhërat e ekzekutimit janë lëshuar nga organi i prokurorisë me dy deri në katër ditë me vonesë.
- Në rastet kur personat kanë qënë me masë sigurie, nga Prokuroria e rrethit gjyqësor Tiranë janë ndjekur afate më të gjata se Prokuroria e rrethit gjyqësor Durrës, kun në të shumtën e rasteve janë lëshuar në më shumë se 3 ditë.
- Situata e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore me masa mjekësore në një institucion psikiatrik të parashikuar nga neni 46 i Kodit penal, vazhdon të zbatohet në kundërshtim me ligjin pavarësisht se është një shqetësim I vazhdueshëm që nga viti 1997. Kjo kategori personash vendoset në kundërshtim me ligjin në Institucione penitenciare si Qendra spitalore e Burgjeve dhe Institucioni Zahari Krujë.
- Aktualisht ndodhen rreth 130 persona me masa mjekësore shtrim të detyruar në një institucion psikiatrik që vendosen në këtë sistem.
- Nga studimi i vendimeve gjyqësore dhe urdhrave të ekzekutimit të Prokurorisë është evidentuar se nga vetë prokurorët dhe më pak gjyqtarët përcaktohet një nga Institucionet penitenciare se ku do të vendosen këta persona.

Vendosja e këtyre personave në institucione penitenciare cënon gjithashtu të drejtën e tyre për një shërbim shëndetësor të përshtatshëm si dhe gjithashtu krijon mbipopullim artificial në institucionet penitenciare.

Rekomandime

- Zbardhjen e vendimeve gjyqësore brenda një afati të shkurtër dhe nxjerrja e urdhërave të ekzekutimit nga ana e Prokurorisë menjëherë, me qëllim që të mos cënohen të drejtat e njeriut. Këshilli I Lartë i Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme duhet të ushtrojnë inspektime dhe kontrole lidhur me respektimin e afateve.
- Marrjen e masave të menjëhershme për ngritjen e një institucioni të posaçëm për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ku jepen masat mjekësore të detyrueshme në një institucion spitalor.
- Ngritjen e një grupi me përfaqësues të dy Ministrive të Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë si dhe Prokurorisë së Përgjithshme për zgjidhjen e kësaj situate.
- Marrjen e masave nga Prokuroria e përgjithshme që deri në ndërtimin e një Institucioni të Posaçëm për këtë kategori, për të ekzekutuar masat me mjekim të detyruar në Institucione të tjera psikiatrike, jashtë sistemit penitenciar.
- Rekomandojmë, Këshillin e Lartë të Drejtësisë që nëpërmjet inspektimeve tematike që kryen të marri masa për ata gjyqtarë të cilët shkelin legjislacioni në fuqi dhe përcaktojnë në vendim se ku do të vendoset personi me masë mjekësore të detyrueshme.
- Marrjen e masave për ngritjen e një Institucioni për zbatimin e masave edukuese për të miturit, autor të veprave penale.